



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
“Financë-Kontabilitet”
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Rezarta SHKURTI PERRI

Dr. Erinda IMERAJ

Dhjetor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në: “Financë Kontabilitet”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financë Kontabilitetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Financë-Kontabilitet”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 654, datë 11.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendimi Senati Nr. 28. datë.28.03.2022 Miratuar nga MASR me shkresë Nr. 2085/1 prot, datë 27.06.2022
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 157, datë 05.06.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 43 studentë; 2022-2023 69 studentë.
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit i ciklit të dytë Master i Shkencave në "Financë-Kontabilitet" është hapur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Rinisë, Nr. 654, datë 11.10.2018 dhe ofrohet nga Fakulteti i Biznesit, i Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës.

Institucioni i Arsimit të Lartë, publik, " Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD) është themeluar në vitin 2005 në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 801. Studimet në këtë Institucion u ofruan për herë të parë në vitin akademik 2006-2007. UAMD është riorganizuar sipas Vendimit numër 685, dt 25.08.2010 në 5 fakultete të cilat janë edhe njësitë kryesore aktuale të Institucionit konkretisht:

- 1. Fakulteti i Biznesit;**
2. Fakulteti i Edukimit;
3. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit;
4. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike;
5. Fakulteti i Studimeve Profesional;

UAMD ka marrë akreditimin institucional të parë në bazë të Vendimit Nr. 10, datë 07.04.2017, të Bordit të Akreditimit të ASCAL dhe është riakredituar me Vendimin nr. 18, datë 24.03.2022 nga Bordi i Akreditimit të ASCAL, duke përmbushur kështu kërkesat ligjore për themelimin dhe akreditimin institucional. Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Kontabilitet ofrohet nga Fakulteti i Biznesit, si njësi kryesore. Ky Fakultet është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 801, dt 20.12.2006. (Kur u krijua ai njihej si Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit, ndërsa që nga viti 2010 emërtohet si "Fakulteti i Biznesit" (FB) në përputhje me riorganizimin e institucionit)

Fakulteti i Biznesit (FB), në UAMD përbëhet nga 6 njësi bazë:

- 1. Departamenti i Financë-Kontabilitet;**
2. Departamenti i Menaxhimit;
3. Departamenti i Marketingut;
4. Departamenti i Shkencave Ekonomike;
5. Departamenti i Turizmit;
6. Departamenti i Statistikës dhe i Informatikës së zbatuar;

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, pranë FB është njësi bazë përgjegjëse që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në "Financë Kontabilitet". Ky program studimi është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, si pjesë e fushës së financës dhe kontabilitetit. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky program është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integrale, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.




Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike (katër semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në "Financë Kontabilitet". Objektivi kryesor i këtij programi është edukimi dhe kualifikimi shkencor i studentëve në fushën e financës dhe të kontabilitetit, përmes integritit të mësimit të njohurive themelore në këto fusha me praktikën dhe njohuritë aplikative. Gjithashtu, ky program studimi synon të sigurojë një nivel njohurish në fushën e financës dhe kontabilitetit të krahasueshëm me programet e studimit të nivelit master të institucioneve analoge ndërkombëtare.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në datën 21.01.2022, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD) ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Financë – Kontabilitet". ASCAL bazuar në *“Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”* ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof. Dr. Rezarta Shkurti Perri** pedagoge në FEUT, Departamenti i Kontabilitetit dhe **Dr. Erinda Imeraj**, Pedagoge në Universitetin Epoka. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, **Msc. Majlinda Demirneli**.

Në afatin kohor 24.04.2023 - 15.05.2023 ekspertëve të jashtëm iu dha në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 4 dhe 5 Korrik 2023 në ambientet e UAMD. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët pas vizitës në Institucion u vu në dispozicion në sistemin e informacionit të ASCAL datën 11.07.2023. Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Master i Shkencave në "Financë-Kontabilitet".

Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.



Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 08.11.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 15/174 Prot, datë 08.11.2023. Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës më datë 24.11.2023, njofton, me anë të shkresës me Nr.2139 Prot, datë 22.11.2023 "Mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Për komentin e IAL mbi *standardin II.1 tek rubrika "Konkluzione"*, GVJ pavarësisht përgjigjes nga IAL, tërësisë së lëndëve të profilit të Financës i mungojnë lëndë që, në gjykimin tonë, gjithashtu janë të rëndësishme në formimin e profesionistëve të fushës përkatëse dhe në përputhje me objektivin e programit të studimit. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon**
2. Për komentin e IAL mbi *standardin III.4 tek rubrika "Konkluzione"*, GVJ gjykon se edhe nëse IAL ka ndërthurur tema të fushës së Etikës në lëndën Bazat e Mashtrimit Kontabël, kjo nuk do të thotë që studentët pajisen plotësisht në fushën humane dhe sociale sikurse ky standard kërkon. Së dyti, nëse në lëndën Bazat e Mashtrimit Kontabël janë futur tema të Etikës, titulli dhe emërtimi i lëndës duhet të përshtatet që ta reflektojë këtë gjë. Së treti, GVJ nuk ka mundur të lokalizojë lëndën Bazat e Mashtrimit Kontabël në dosjen e syllabuseve, kjo ndoshta për shkak të vështirësisë së punës me formatin e dokumentacionit të dërguar. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
3. Për komentin e IAL mbi *standardin IV.1 tek rubrika "Konkluzione"*, GVJ vlerëson angazhimin e njësisë bazë mbi përmirësimin e raportit PAE/ PAK për vitet në vijim dhe faktin që stafi me MSC aktualisht është në proces doktorature, fakt ky që do ndikojë pozitivisht dhe do plotësojë standartet e kërkuara në respektim të rregulloreve në fuqi. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet” (në vijim, MSHFK) ofrohet nga Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës. Sipas deklarimit të vetë Institucionit, në Planin e Zhvillimit Strategjik të tij, UAMD në gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimit i lartë. Në Statutin e Institucionit, (neni 4, pika 1), shihet se UAMD ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor të realizuar me veprimtari transparente. Neni 5 i Statutit garanton lirinë akademike, financiare dhe organizative të tij.</p> <p>Sipas Planit Strategjik të Zhvillimit të UAMD (2020- 2025), integrimi i tij në proceset social-ekonomike, garanton një shtysë të rëndësishme të komponentëve të ndryshëm të shoqërisë, në mirëqënien dhe ndërgjegjësimin e saj. Universiteti, synon të jetë faktor vendimtar në “ekonominë e dijes”, nëpërmjet formimit të profesionistëve të rinj, të gatshëm të përballen me sfidat e tregut të punës dhe në të njëjtën kohë të shfrytëzojnë mundësitë që bota dhe tregjet ndërkombëtare ofrojnë.</p> <p>Po kështu, në Planin Strategjik të Fakultetit të Biznesit e cila është njësi kryesore që ofron këtë program studimi, shihet se misioni i tij është të sigurojë njohuri të vazhdueshme, bashkëkohore dhe të thella të studentëve të cilat të jenë të përshtatshme me traditat shqiptare, standardet europiane dhe kërkesat e grupeve të interesit rajonal. Sikurse formulohen</p>

	<p>qëllimet dhe objektivat e institucionit në dokumentat strategjike të tij, duket se UAMD është i orientuar në fusha që kanë rëndësi për zhvillimin e interesave të vendit, që janë të themeluara në traditat shqiptare dhe synojnë të shtojnë cilësinë e studimeve universitare në vend. GVJ konfirmon përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të Universitetit Aleksandër Moisiu , Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Fakulteti i Biznesit 2021-2026 dhe 2015-2020.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>GVJ konstaton se në misionin e tij, universiteti ka për qëllim: “nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin” (Statuti neni 3). Vetë programi i studimit MSHFK ka si mision edukimin e thelluar, nxitjen e kërkimit të avancuar, përmirësimin e aftësive praktike në fushat e financës dhe kontabilitetit. (Plani Strategjik i Programit të studimit 2019 - 2023, pika 2). Ky program studimi synon që të arrijë disa objektiva për studentët: - t’i aftësojë ata për punë kërkimore dhe zhvilluese në dobi të firmave, industrive, institucioneve publike dhe të instituteve kërkimore shkencore; të krijojnë shtesë vlerash përgjatë karrierës së studentëve në përgjigje të oportuniteteve të ndryshme që mund të hasen; të përgatiten profesionistë në fushën e kontabilitetit, në mënyrë që të zhvillojnë aftësitë e nevojshme analitike për të zgjidhur problemet që lidhen me fushën e kontabilitetit dhe finances; të ofrohen njohuritë e nevojshme në standardet e raportimit financiar, të etikës së biznesit dhe përgjegjësisë së drejtuesve financiarë; të aftësohen për të zbatuar vendimet e duhura dhe për të ditur si të përdorin informacionin e publikuar në pasqyrat financiare sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare; të realizojnë teknika sa më të përparuara për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e rrezikut.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p>

	<i>Plani Strategjik i Zhvillimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2019-2023.pdf</i>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi Planin e Zhvillimit Strategjik në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë në UAMD, si edhe në nivel programi studimi dhe harmonizimin e tyre me dokumente të rëndësishëm institucionale si Statuti dhe Rregullorja e UAMD. Në të gjitha këto dokumente strategjike GVJ konstatoi një ndërthurje organike dhe konsistente mes synimeve afatgjata të institucionit, që janë shprehur edhe me hapjen e këtij programi studimi në vitin 2019. Pika 1 e Planit Strategjik të Programit MSHFK thekson se programi ofron një qasje të integruar që kombinon njohuritë thelbësore praktike të kontabilitetit dhe njohuritë e aplikimit të financave me kërkimin dhe aftësitë analitike të cilat janë në përputhje me kërkesat e tregut. Pas përfundimit të programit, të diplomuarit pritët që të demonstrojnë qartë të menduarit e pavarur në planifikimin dhe zbatimin e detyrave në nivel profesional. Vizioni i programit është që të bëjë të mundur zhvillimin e njohurive dhe aftësive analitike të nevojshme për të hartuar dhe zbatuar sisteme të menaxhimit të të dhënave të nevojshme për hartimin e raporteve dhe pasqyrave financiare, analizimin e tyre, planifikimin dhe kontrollin e performancës së një njësie ekonomike (Plani Strategjik i programit mësimor MSHFK, pika 3).</p> <p>Sikurse shihet në këto dokumenta, programi MSHFK është i hartuar në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Institucionit dhe vjen si zbatim i strategjisë afatgjatë të tij.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik 2020-2025 të Universitetit Aleksandër Moisiu , Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025 .pdf</i></p> <p><i>Planifikimi i Veprimtarive Strategjike 2021-2023 të Universitetit "Aleksandër Moisu", Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2019-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e</p>	<p>GVJ konstaton nga analiza e objektivave formues të programit të studimit, (pika 2 e Planit Strategjik të Programit dhe neni 4 i</p>

<p>zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Rregullores së Programit të Studimit) se synimi i tij paraqitet në përputhje me Strategjinë Kombëtare për zhvillim dhe integrim (2015 – 2020) e cila ishte në fuqi në periudhën e hartimit dhe ideimit të këtij programi studimi. Sic shihet në RVB për këtë kriter, Institucioni, përvec strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, kur ka hartuar programin e studimit MSHFK është bazuar edhe në dy dokumenta të tjerë të rëndësishëm: Strategjinë Kombëtare për Teknologjinë, Shkencën dhe Inovacionin 2017-2021, dhe në përputhje me orientimin e programit edhe Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive në Shqipëri (2021 – 2024).</p>
	<p>Sipas Planit Strategjik të Programit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet, ky i fundit synon formimin profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën Financës dhe Kontabilitetit, të cilët do të jenë të aftë të përballen me sfidat kombëtare, por edhe ato globale të cilat direkt apo indirekt kanë ndikim në ekonomi. Për arritjen e këtij misioni, gjatë viteve të studimit ofrohet një bazë e thelluar teorike, aftësim në metodat e kërkimit dhe kualifikim profesional në fushat e financës dhe kontabilitetit. Si përfundim, në gjykimin e GVJ, përgatitja e profesionistëve në fushën e financës dhe të kontabilitetit të aftë që të punojnë në vend apo të ndjekin studime të avancuara të mëtejshme përbën një objektiv në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe integritit, atë të teknologjisë dhe shkencës, si edhe planin e veprimit për përmirësimin e raportimit financiar në vend.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2019-2023.pdf</i></p> <p><i>Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020.pdf</i></p> <p><i>Strategjia Kombëtare për Teknologjinë, Shkencën dhe Inovacionin 2017-2021.pdf</i></p> <p><i>Strategjia dhe Plani i Veprimit për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive në Shqipëri (2021 - 2024).pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në gjykimin e GVJ, programi i studimit paraqitet i kompletuar për të garantuar përmbushjen e interesave dhe vlerave kombëtare përsa ato lidhen me drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Programi ndihmon në avancimin drejt arritjes së një niveli më të lartë të zhvillimit të tregjeve financiare</i></p>



	<i>dhe të raportimit kontabël në vend. GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht nga ana e Institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UAMD, mesa paraqitet në dokumentacionin e dorëzuar duket se disponon kapacitetet e nevojshme akademike dhe burimet e duhura infrastrukturore për të ofruar studime të nivelit të dytë, si Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se UAMD është themeluar në vitin 2005 dhe qysh në fillim ka celur Fakultetin e Biznesit duke ofruar studime në fushën e financës, bankës dhe të kontabilitetit. UAMD dhe FB kanë edhe një program të nivelit Bachelor në të njëjtën fushë studimi dhe mesa paraqitet në strukturën organizative të Institucionit dhe mbështetur në dosjen e CV të personelit të angazhuar në programin e studimit, kualifikimet e tyre vitet e fundit dhe trajnimet jashtë vendit, përputhshmërinë e formimit të stafit me angazhimin e tyre pranë departamentit, Institucioni demonstroi se ka burime njerëzore të nevojshme dhe të kualifikuara për të ofruar programe studimi në këtë fushë.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>CV-të e lektorëve, Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Kualifikimi dhe kërkimi shkencor i PAE në 5 vitet e fundit.pdf</i></p> <p><i>Trajnime dhe mobilitete Erasmus _PAE.pdf</i></p> <p><i>Përputhja e Formimit me angazhimin për personelin akademik F-K.pdf</i></p> <p><i>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>

<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MSHFK ofrohet nga Fakulteti i Biznesit në UAMD si njësi kryesore përgjegjëse. GVJ gjykon se fusha e përgjithshme e programit të studimit (ekonomia dhe biznesi) dhe fusha specifike (financa dhe kontabiliteti) janë në përputhje me orientimin e njësisë kryesore. Programi i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Sipas VKM nr 310/2022 në lidhje me kodifikimin dhe përmbajtjen e programeve të studimit të ofruara në Republikën e Shqipërisë, pika 2/dh, programet Msc duhet të fillojnë me kodin 72 MS. Sic u konfirmua edhe nga shkresa e përpiluar nga njësi bazë që ofron programin e studimit, DFK ka propozuar që ky program të ketë kodin, 72MS0411S. Gjatë kohës së vizitës në Institucion, GVJ u informua se Institucioni është në pritje të finalizimit të procesit të kodifikimit dhe shkresave përkatëse nga Ministria përgjegjëse dhe shprehet për përmbushje të plotë të këtoj kriteri.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Organigrama e Universitetit Aleksandër Moisu.pdf</i></p> <p><i>Kërkesë për propozime të kodifikimit të programeve të studimit.pdf</i></p> <p><i>Shkresë për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Financë Kontabilitetit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Njësi bazë që ofron programin e studimit MSHFK në UAMD është Departamenti i Financë Kontabilitetit. Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamentit specifikon se qëllimi i tij është që si departament i Financë Kontabilitetit të jetë i angazhuar të aftësojë studentët për punë kërkimore dhe zhvilluese në dobi të firmave, industrive, dhe të instituteve kërkimore shkencore për gjetje dhe zhvillim përvojash si brenda vendit, rajonit dhe në rang më Global. Misioni i Departamentit të Financë Kontabilitetit është të ofrojë programe studimi në ciklin e parë, të dytë dhe në ciklin e tretë të studimeve, të cilat do të përgatitin studentë cilësorë, profesionistë dhe konkurrues në treg. MSHFK në UAMD nuk është një program ndërdisiplinor.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program</p>	<p>Nuk ka aplikim për këtë program studimi</p>

<p>“Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në RVB të Institucionit për këtë kriter përmenden marrëveshjet e bashkëpunimit mes UAMD dhe FB dhe partnerëve të tjerë si edhe disa organizime të leksioneve të hapura në Institucion. GVJ mbështet këtë dokumentacion dhe gjatë vizitës në Institucion u informua për numrin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi dhe mënyrën sesi ruhen kontaktet dhe bashkëpunimet me ta. Sipas informacionit të marrë u konstatua se rrejtja e studentëve alumni ndiqej në mënyrë rigorozë dhe ftohej të bëhej pjesë e panairëve të unës si përfaqësues të kompanive ku ishin punësuar.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmjet UAMD dhe Partnerëve.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe Partnerëve.pdf</i></p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete, Dep. Financë – Kontabilitet _Njoftim në faqet sociale për Trajnim dhe Punësim Deloitte.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjen një përputhje të plotë mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit MSHFK dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, FB dhe njësisë bazë, DFK. Evidencë e kënaqshme u gjet gjithashtu edhe për ruajtjen e kontakteve akademike dhe profesionale me studentët e diplomuar. GVJ është e opinionit se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit

të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Dokumentacioni i vendosur në dispozicion të GVJ për këtë kriter ishte i plotë dhe gjithëpërfshirës duke përfshirë statutin dhe rregullore të të gjitha niveleve (Institucionale, njësi kryesore, njësi bazë, program studimit) që mbulonin pothuajse cdo aspekt të organizimit të detyrave dhe përgjegjësive në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të programit të studimit. Bashkëpunimi përbrenda personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ përshkruhet qartë në Statutin e Institucionit dhe Rregulloret e funksionimit në nivel institucioni, njësie kryesore dhe njësie bazë, si edhe në rregulloren e programit të studimit, dhe të gjitha këto ishin, në opinionin e GVJ, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015. GVJ hasi evidencë edhe për analizën e vazhdueshme të aktiviteteve qoftë në kuadrin e analizës vjetore të njësisë bazë që ofron programin, ashtu edhe të një dokumenti të dedikuar për shqyrtimin e ecurisë së programit MSHFK.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Ligji për Arsimin e Lartë 80-2015.pdf</i></p> <p><i>Statuti i UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Ecuria e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit, se UAMD ka siguruar evidencë që ka arritur të garantojë një larmi marrëveshjesh bashkëpunimi qoftë me Institucione partnere IAL brenda dhe jashtë vendit, për realizimin e projekteve të përbashkëta me fokus kërkimin dhe trajnimet dhe që japin mundësi për realizimin e leksioneve me profesorë të huaj, por edhe me kompani dhe njësi biznesi, banka, shoqëri tregtare, etj</p>

<p>brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>që ofrojnë potencial për organizimin e trajnimeve në terren cka janë aktivitete me rëndësi për formimin e specialistëve të lartë në financë dhe kontabilitet. Një përmbledhje e të dhënave në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit shihet edhe në tabelën 5 në RVB dhe konfirmohen edhe nga personeli akademik i DFK.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmjet UAMD dhe Partnerëve.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe Partnerëve.pdf</i></p> <p><i>Tabelat e RVB tw programit tw studimit.</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ gjykon se përmbajtja e marrëveshjeve të bashkëpunimit sic janë të deklaruara në DVV dëshmon për një larmi aktivitete që mund të ndërmerren (praktika, trajnime në institucion dhe në vendin e punës) dhe që angazhojnë partnerë si shoqëri tregtare, dhoma tregtie, studio kontabiliteti, institute kërkimore, etj, cka mundëson realizimin lehtësisht të praktikave mësimore dhe profesionale në fushën e financës dhe të kontabilitetit. Po kështu, marrëveshjet e lidhura me IAL të tjera, sidomos universitete dhe kolegje jashtë vendit, japin mundësi për kryerjen e shkëmbimeve kërkimore dhe akademike për stafin dhe studentët e programit të studimit. Shtimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, dhe rritja e mobiliteteve është ndër të tjera edhe një nga qëllimet e strategjisë së zhvillimit të njësisë bazë që ofron programin e studimit dhe mesa u konstatua gjatë vizitës në Institucion ishte një element vlerështues për studentët që ndiqnin këtë program studimi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmjet UAMD dhe Partnerëve.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe Partnerëve.pdf</i></p> <p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga</p>	<p>GVJ formoi opinionin se Departamenti i Financë Kontabilitetit paraqitet i qëllimshëm për të analizuar përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit që UAMD dhe FB kanë me partnerët brenda dhe jashtë vendit. Në dokumentin e analizës së</p>

<p>marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>marrëveshjeve mund shihet se këto përfitime mund të përmbliidhen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e përvitshme me përfaqësues të Drejtorisë së Tatimeve, Durrës; përfaqësues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe të tjerë. Përmes këtyre aktiviteteve studentët e masterit shkencor mund të marrin njohuri praktike për dokumentacionin kontabël dhe mbajtjen e tij, anën ligjore, raportimet financiare, etj; • Praktikant mësimore pranë bizneseve private, bankave, kompanive të sigurimit dhe institucione të tjera; • Angazhimit në mësimdhënie të specialistëve në këto institucione, për lëndë të cilat ndikojnë në formimin dhe njohuritë e studentëve; • Bashkëpunimeve në botime dhe konferenca, duke gërshtuar literaturën bashkëkohore me shifrat, rastet e studimit dhe vëzhgimet, si të dhëna të kërkimit primar; <p>Referenca:</p> <p><i>Analiza e Marrëveshjeve të Departamentit F-K.pdf</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UAMD ka realizuar me sukses organizimin eficient të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësiave për të garantuar mbarëvajtjen e aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe shkencore në funksion të programit të studimit MSHFK. Tërësia e rregulloreve të hartuara në cdo nivel nuk lejon hapësira për cënimin e autoritetit dhe përgjegjësisë. UAMD ka një listë të pasur të marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë, IAL dhe shoqëri biznesi nëpërmjet të cilëve diversifikon portofolin e aktiviteteve të ofruara për studentët e programit MSHFK. DFK angazhohet në analizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit duke nxjerrë në pah pikat më të forta të partneritetit. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri nga ana e Institucionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Plani Mësimor i Programit të Studimit MSHFK në UAMD (Tabelat e RVB), paraqet lëndët të ndara sipas veprimtarive formuese (A-E). Lëndët / modulet janë të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe të vlerësuara me kredite mësimore sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Totali i krediteve të programit është 120 kredite (neni 11, pika 1.a e Rregullores së Programit të Studimit).</p> <p>Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në programin e studimit MSHFK janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, në përputhje me VKM nr. 41/2018 të ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021. Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, C, D dhe E janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe vlerësohen secila me kredite. (Sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM nr. 879/2019 dhe VKM nr. 185/2021, Tabela nr 1, për programet e Masterit Shkencor, në kategorinë A ku bëjnë pjesë lëndët bazë dhe disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturore të përgjithshme duhet të kenë 5 – 10% të krediteve; në kategorinë B, që janë lëndët karakterizuese, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të ketë 50 – 60% të krediteve; në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore dhe integruese, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje dhe duhet të ketë 12 – 20% të krediteve; në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10% të krediteve. Ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim dhe duhet të ketë 10 – 15% të krediteve. Me qëllim lehtësimin e integritit të studentëve të diplomuar pranë UAMD-së në tregun e punës, por edhe për</p>

	<p>vazhdimin e mëtejshëm të studimeve jashtë vendit, ofrohet edhe konvertimi në kredite sipas Sistemit Amerikan UsCr. (neni 11, pika 1.a e Rregullores së Programit të Studimit).</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Tabelat permbledhese te RVB-se pwr programin e studimit MSHFK.</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ konstaton se rregullorja e programit të studimit MSHFK në UAMD (neni 4) parashikon se ky program synon formimin e profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën e Financës dhe Kontabilitetit, të cilët do të jenë të aftë të përballen me sfidat kombëtare, por edhe ato globale të cilat direkt apo indirekt kanë impakt në ekonomi. Për arritjen e misionit të tij, Institucioni synon të ofrojë një bazë të thelluar teorike, aftësim në metodat e kërkimit dhe kualifikim profesional në fushat e financës dhe kontabilitetit. Objektiva të programit (sipas rregullores përkatëse) janë ndër të tjera edhe: pajisja e studentëve me njohuri bashkëkohore shkencore në disiplinat e financës dhe kontabilitetit, me aftësitë e duhura për t'u integruar në tregun e punës dhe për të shpalosur njohuritë e fituara dhe zotësinë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, ofrimin e sugjerimeve dhe ideve të reja në këto disiplina.</p> <p>Për të gjykuar mbi shkallën e arritshmërisë së këtyre synimeve dhe objektivave të programit të studimit, GVJ shqyrtoi Planin Mësimor dhe syllabuset përkatëse. GVJ është e mendimit se tërësia e moduleve dhe lëndëve të organizuara në kurrikulën e këtij programi (tabelat e RVB), me larminë e tyre dhe me ngarkesën e parashikuar mundësojnë përmbushjen vetëm kryesisht të synimeve dhe objektivave të përmendura në rregulloren e programit, për shkak të dy faktorëve.</p> <p><u>Së pari</u>, tërësia e lëndëve duket sikur anon nga kontabiliteti (p.sh., vetëm Kontabiliteti Financiar i Ndërmjetëm dhe i Avancuar ka 21 ECTS), dhe përmban edhe lëndë të tjera që në gjykimin e GVJ janë dytësore për nivelin master në Financë Kontabilitet (si menaxhim operacionesh, marketing, ekonomiks) duke mos ofruar njëkohësisht njohuri për disa lëndë të rëndësishme financiare (si Drejtimi Financiar Ndërkombëtar, apo menaxhim investimesh dhe portofoli).</p>

	<p><i>Në gjykimin e GVJ ky kompozim i lëndëve të përfshira në Planin Mësimor nuk ofron një balancë të njohurive të ofruara për studentët. Për më tepër duket se disa lëndë të ofruara në këtë program studimi me fokus kontabilitetin, kanë një dublim me lëndë të ofruara në nivelin bachelor në programin e studimit me të njëjtin emër (Bachelor në Financë Kontabilitet) (p.sh., kontabiliteti i institucioneve financiare; analiza e pasqyrave financiare), pavarësisht se sipas pedagogëve të DFK trajtimi i këtyre lëndëve bëhet në nivele të ndryshme në të dyja programet e studimit; tabela 9 në RVB).</i></p> <p>Së dyti për shkak të shpërndarjes së disbalancuar me leksioneve dhe seminareve (tabela 10 në RVB) GVJ vëren se në pothuajse të gjitha lëndët (kategoritë, A, B, C, D) janë parashikuar dyfishi i orëve të leksionit kundrejt seminareve, cka, në gjykimin e GVJ cënon mundësinë dhe kohën e studentëve për t'u praktikuar në cdo lëndë. Lidhur me këtë vëzhgim, GVJ u informua megjithatë gjatë vizitës në Institucion se organizimi i orëve në auditor ishte lënë i lirë dhe pedagogët kishin mundësinë të shtonin kohën e trajtimit të ushtrimeve dhe rasteve praktike e të kufizonin kohën e trajtimit të materiait teorik.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese te RVB-se pwr programin e studimit MSHFK.</i></p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga analiza e Planit Mësimor mund të konstatohet se në kurrikulën e Programit të Studimit MSHFK janë përcaktuar ngarkesa në kredite, si edhe elementet e tjera (orët mësimore për leksionet, punë individuale dhe aktivitete të tjera) për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Studentët e këtij program studimi i nënshtrohen praktikës profesionale e cila zhvillohet në semestrin e fundit të studimeve, është e monitoruar nga një pedagog udhëheqës dhe është e vlerësuar me 9 ECTS. Si detyrim përmbyllës, studentët e programit MSHFK, i nënshtrohen provimit të mikrotezës e cila është e vlerësuar me 12 ECTS.</p> <p>Referenca:</p>

	<p><i>Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese te RVB-se për programin e studimit MSHFK.</i></p> <p><i>Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe</p>	<p>Programi i studimit MSHFK në UAMD është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe, në</p>

<p>financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>dijeninë e GVJ, as programi i studimit dhe as Institucioni nuk gëzojnë status të veçantë.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Statuti i UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Deklarata Master Shkencor Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Ligji për Arsimin e Lartë 80-2015.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>
--	---



<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter Institucioni nuk shprehet por në DVV ka përfshirë dokumentin e emërtuar “Programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare Master i Shkencave në Financë - Kontabilitet”. Në këtë dokument listohen programe të ngjashme të ofruara në universitete brenda vendit dhe jashtë tij dhe kurrikulat përkatëse por pa ofruar një analizë të mirëfilltë krahasuese mes tyre, dhe madje pa pasur as informacion të detajuar për programet respektive.</p> <p>Megjithatë, mbështetur në kurrikulën e programit MSHFK, dhe në përmbajtjen e programeve lëndore të tij, GVJ shprehet se, mesa ka dijeni dhe informacion, duke e krahasuar me programe me të njëjtin emërtim dhe nivel në IAL të tjera të vendit, përmbajtja e programit të studimit MSHFK në UAMD ka një nivel ngjashmërie afërsisht 70%. Diferencat prej afro 30% lidhen me dy konstatime të nxjerra nga GVJ (shprehur edhe në kriterin 1 më lart):</p> <ul style="list-style-type: none"> - lëndë të pakta ose të kufizuara të disiplinës financë; - lëndë jo prioritare për programin e studimit sidomos në nivelin e dytë. - shpërndarje e pabarabartë mes orëve të leksioneve dhe seminareve të cilat, në gjykimin e GVJ, duke anuar nga leksionet, çënojnë mundësinë e studentëve të programit të aftësohen nga ana praktike mësimore në auditor; <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023.pdf</i></p> <p><i>Programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombetare Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet</p>	<p>GVJ ndeshi evidencë në DVV se Institucioni ka ndërmarrë hapa për kodifikimin e programeve të studimit, mes tyre edhe programin MSHFK, në përputhje me VKM 310/2022. Në shkresën “Kodifikimi i Programeve të studimit, UAMD” shihet se kodi i propozuar për programin MSHFK është 72MS0411S, në përputhje me orientimin e pikës 2, dh, të VKM 310/2022. Përsa i përket kodifikimit të lëndëve të programit, GVJ u</p>

kodifikimi i lëndëve të programit.	informua gjatë vizitës në Institucion se po punohej në këtë drejtim. Referenca: <i>Kodifikimi i programve të studimit UAMD.pdf</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit MSHFK është i organizuar, në përputhje me elementet e kërkuara ligjore, në veprimtari formuese të emërtuara në kredite europiane. Programi i studimit është afërsisht 70% i ngjashëm në përmbajtje dhe strukturë me programe me të njëjtin emërtim GVJ konstaton se tërësia e lëndëve të ofruara për studentët duhet të rishikohet me qëllim përfshirjen e më tepër lëndëve të profilit financë, duke shmangur njëkohësisht përsëritjet me lëndët e ofruara tashmë në nivelin e parë Bachelor dhe përfshirjen e lëndëve jo prioritare për programe studimit. Mbështetur në këto konstatime, GVJ gjykon se ky kriter përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	<i>Nuk përmbushet</i>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin	Programi i studimit MSHFK është hapur në vitin akademik 2018 - 2019 dhe i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë. UAMD është themeluar në vitin 2005 në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 801. Studimet në këtë Institucion u ofruan për herë të parë në vitin akademik 2006-2007. UAMD

<p>në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>është riorganizuar sipas Vendimit numër 685, dt 25.08.2010 në 5 fakultete të cilat janë edhe njësitë kryesore aktuale të Institucionit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Edukimit; 2. Fakulteti I Biznesit; 3. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit; 4. Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike; 5. Fakulteti i Studimeve Profesionale; <p>UAMD ka marrë akreditimin institucional të parë në bazë të Vendimit Nr. 10, datë 07.04.2017, të Bordit të Akreditimit të ASCAL dhe është riakredituar me Vendimin nr. 18, datë 24.03.2022 nga Bordi i Akreditimit i ASCAL, duke përmbushur kështu kërkesat ligjore për themelimin dhe akreditimin institucional.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Kontabilitet ofrohet nga Fakulteti i Biznesit, si njësi kryesore e cila është hapur me VKM, Nr. 801, dt 20.12.2006. (Kur u krijua ai njihej si Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit, ndërsa që nga viti 2010 emërtohet si “Fakulteti i Biznesit” (FB) në përputhje me riorganizimin e institucionit.) GVJ analizoi shkallën e përmbushjes së kërkesave ligjore në fuqi që specifikojnë se “njësia kryesore duhet të organizohet në së paku tri njësi bazë, së paku dy prej të cilave janë departamente”, dhe konstaton se Fakulteti i Biznesit në UAMD, e përmbush këtë kriter pasi ka në përbërjen e tij gjashtë departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Financë-Kontabilitet; 2. Departamenti i Menaxhimit; 3. Departamenti i Marketingut; 4. Departamenti i Shkencave Ekonomike; 5. Departamenti i Turizmit; 6. Departamenti i Statistikës dhe i Informatikës së zbatuar; <p>Fakulteti i Biznesit në UAMD ofron gjithsej 20 programe studimi (tabela 3 në anekset e RVB): 6 programe studimi në nivelin bachelor, 6 programe studimi në Master i Shkencave, 4 programe studimi në Master Profesional dhe 4 programe studimi doktorature. Njësia bazë që ofron programin MSHFK, Departamenti Financë Kontabilitet, sipas tabelës 3 në RVB, dhe sipas dokumentit “Programet e studimit të ofruara nga Departamenti Financë-Kontabilitet” ofron gjithsej 7 programe studimi: 2 programe studimi në nivelin bachelor, 3 programe</p>
--	--

studimi në Master i Shkencave, 1 program studimi në Master Profesional dhe 1 program në doktoraturë).

Në përputhje edhe me tabelat në RVB (tabela 1) për këtë program, shihet se departamentet e Fakultetit të Biznesit përmbushin kërkesat ligjore për numrin e stafit akademik efektiv, PAE (cdo njësi bazë duhet të ketë të paktën 7 PAE, ndër të cilët 3 të jenë me tituj dhe grada). I vetmi departament që nuk përmbush këtë kriter është ai i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar i cili, megjithatë nuk është njësi bazë që ofron programin e studimit MSHFK dhe është departament i ri i krijuar vetëm në vitin e fundit akademik 2022 - 2023.

Tabelat në vijim paraqesin përbërjen e stafit efektiv PAE dhe me kontratë PAK për njësinë kryesore, njësinë bazë dhe stafin e angazhuar në programin e studimit. Fakulteti i Biznesit përmbush detyrimet për stafin akademik.

Kualifikimi i stafit akademik të	Fakulteti i Biznesit					
	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	5	6	6	6	5	7
Prof. Asoc.	11	11	10	10	13	11
Dr/Phd	43	20	43	17	40	13
Msc.	12	60	13	42	11	38
Gjithsej	71	97	72	75	69	69

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit MSHFK në UAMD është Departamenti i Financë-Kontabiliteti. Referuar të dhënave të RVB, GVJ konstaton se kjo njësi bazë përmbush kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm (PAE) dhe atë me kontratë (PAK).

Kualifikimi i stafit akademik të	Departamenti i Financë Kontabilitet					
	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	1	2	2	2	1	2

	Prof. Asoc.	1	3		3	1	5												
	Dr/Phd	10	7	10	7	9	5												
	Msc.	5	21	5	20	5	14												
	Gjithsej	17	33	17	32	16	26												
	<p>GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë përmbushin kërkesat ligjore për organizimin, strukturën dhe kualifikimin e tyre, si edhe për raportet mes personelit PAE dhe PAK.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Tabelat përmbledhëse të RVB</i></p> <p><i>VKM nr. 801 datë 20.12.2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës Ligjet.org - Për hapjen e universitetit Aleksandër Moisiu në Durrës.pdf</i></p> <p><i>VKM nr. 685, datë 25.08.2010 Për riorganizimin e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës .pdf</i></p> <p><i>Vendim nr. 10 datë 07.04.2017 i Bordit të akreditimit Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës .pdf</i></p>																		
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Sic konfirmohet në tabelën 1 në RVB të programit të Studimit MSHFK në UAMD angazhohen në rolin e personelit ndihmës akademik, PNA sipas viteve sa më poshtë në nivel njësie kryesore, FB dhe njësi bazë, DFK.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Personeli administrativ</th> <th>2022 – 2023</th> <th>2021 – 2022</th> <th>2020 - 2021</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>PNA në FB</td> <td>15</td> <td>15</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>PNA në DFK</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> <p>Më tej, në nenin 20 të Rregullores së njësisë bazë parashikohen detyrat e PNA si në vijim: "Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ i punësuar pranë Departamentit të Financë Kontabilitetit ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të universitetit në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në kategorinë e personelit ndihmës akademik me karakter administrativ përfshihet</p>							Personeli administrativ	2022 – 2023	2021 – 2022	2020 - 2021	PNA në FB	15	15	10	PNA në DFK	3	3	2
Personeli administrativ	2022 – 2023	2021 – 2022	2020 - 2021																
PNA në FB	15	15	10																
PNA në DFK	3	3	2																

	<p>punonjësja e sekretarisë e cila përpilon, ruan dhe administron dokumentacionin e Departamentit në funksion të procesit mësimor.” Sipas këtij përshkrimi shihet se pjesë e detyrave të PNA është edhe angazhimi për realizimin e praktikave në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Tabelat përmbledhëse të RVB</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ konstaton se në nenin 7 të Rregullores së njësisë bazë është parashikuar (ndër të tjera) pozicioni i koordinatorit të programit të studimit si një ndër strukturat e Departamentit të Financë Kontabilitetit. Detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit parashikohen në nenin 15 të rregullores së njësisë bazë. Sipas këtij neni, koordinatori i programit të studimit, është përgjegjës për raportimin pranë Dekanit dhe Drejtuesit të njësisë bazë mbi cilësinë dhe standartet që mbikëqyr; përgatit raporte vjetore kur kërkohet nga Drejtuesi i Njësisë Bazë gjatë një procesi akreditimi, mbi programin që mbikëqyr, duke u bazuar në formatet e përcaktuara; përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut mbi programin e studimit që mbikëqyr; Përgatit dhe përditëson dosjen e programit që mbikëqyr; koordinon punën për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik; programeve lëndore (syllabuset), paketën e praktikës profesionale dhe të udhëzimeve për temën e Diplomimit; kujdeset për implementim të të gjitha aktiviteteve të planifikuara në programin e studimit; mban kontakte me bizneset; mbikëqyr aktivitetet e praktiëks profesionale dhe organizon procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit. Po kështu, pika 3 në rregulloren e programit të studimit përforcon se Koordinatori i programit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet është përgjegjës për zhvillimin dhe ecurinë e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit. GVJ hasi evidencë për përzgjedhjen dhe emërimin e koordinatorit të programit të studimit qysh në fillesat e tij dhe konfirmoi këtë pozicion edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Referenca:</p>

	<p><i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë- Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Memo e Dep. Financë-Kontabilitet për përzgjedhjen e Koordinatorit të Programit Master i Shkencave Financë- Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Sipas konstatimeve të GVJ, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit që janë njësitë përkatëse përgjegjëse për programin e studimit MSHFK përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sa i përket organizimit dhe strukturës akademike, numrit të stafëve akademike efektive dhe me kontratë dhe në lidhje me vlerësimin dhe akreditimin.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV GVJ konstatoi, dokumentat kryesore strategjike të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë që ofrojnë këtë program studimi (Rregullorja e Fakultetit të Biznesit; Rregullorja e Departamentit të Financë Kontabilitetit dhe Rregullorja e Programit të studimit MSHFK) të cilat përmbajnë elementet e nevojshme në lidhje me programin si kohëzgjatjen e tij, organizimin në vite akademike dhe në semestra, në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e elementëve dhe lëndëve të programit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Fakultetit të Biznesit;</i></p> <p><i>Rregullorja e Departamentit të Financë Kontabilitetit</i></p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ shqyrtoi Planin Mësimor të programit në Rregulloren përkatëse (neni 5 dhe aneksi shoqërues nr.2) dhe konfirmon se në të janë parashikuar lëndët që do të zhvillohen sipas semestrave dhe viteve akademike, së bashku me numrin e krediteve ECTS në total dhe për cdo veprimtari, si leksione në auditor, aktivitete të tjera mësimore, dhe orë studimi individual jashtë auditorit. Lëndët e programit të studimit janë të organizuara sipas veprimtarive formuese nga A – E në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacionet e rëndësishme për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve janë përshkruar në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit dhe në Rregulloren e Programit të Studimit. Sipas nenit 9, pika 1, e rregullores së programit të studimit, kuotat dhe kriteret e përgjithshme të pranimit në programet e ciklit të dytë propozohen nga Departamenti i Financë Kontabilitetit, miratohen nga Dekani dhe i përcillen Senatit Akademik, i cili miraton propozimin dhe ia përcjell MAS-it dhe Qëndrës së Shërbimeve Arsimore para fillimit të aplikimeve për pranime. UAMD mund të vendosë edhe kritere shtesë pranimi për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat shpallen publikisht përpara fillimit të aplikimeve. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të BE: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i certifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.</p> <p>Neni 39, pika 8 e Rregullores së Fakultetit të Biznesit shprehet se kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve: a) Kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë, si në Fakultetin në të cilin është kryer programi i ciklit të parë ose në një fakultet tjetër, kjo në përputhje me kriteret e programit mësimor përkatës dhe ato të ministrisë përgjegjëse për arsimin; b) Kandidatët që zotërojnë diplomë studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar e barasvlershme me të; c) Plotësojnë standardet e caktuara akademike të kriterëve të pranimit në ciklin</p>

e dytë të studimeve. Në dokumentin “Vendosja, Miratimi dhe Shpallja e Kriteve të Pranimit për MSH Financë-Kontabilitet V.A. 2023-2024” GVJ hasi evidencë edhe në lidhje me kriteret specifike të pranimit në programin e studimit për vitin e ardhshëm akademik, dhe kjo procedurë ndiqet vit pas viti.

Në lidhje me transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, (Rregullorja e programit të studimit, neni 10), procedurat për transferimin e studimeve fillojnë në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë së fundi i javës së dytë të semestrit të parë. Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në programin MSHFK, bëhet nga Departamenti Financë-Kontabilitetit, sipas procedurave dhe kriteve të përcaktuara në UAMD-së.

Sipas Rregullores së programit të studimit, lënda ose moduli në programin Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet, ekuivalentohet kur:

- a. ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm me lëndën/modulin e programit të studimit ku transferohet;
- b. trajton tema të njëjta ose të ngjashme dhe ka përputhje të ngarkesës në auditor në masën mbi 70% të lëndës / modulit që zhvillohet në programin e studimit në FB;
- c. Studenti mund të transferojë studimet, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda FB apo nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nëse:
- d. ka grumbulluar, sipas formulës së pranimit në programin përkatës të studimit, sasi pikësh më të larta se pragu minimal i pikëve, që është arritur në programin e studimit të kërkuar në vitin përkatës;
- e. ka fituar jo më pak se 30 kredite në programin përkatës të studimit, nga vjen;
- f. plotëson kriteret specifike për transferimin e studimeve të përcaktuara nga Departamenti Financë-Kontabilitet;
- g. Në të kundërt, ai mund të fillojë studimet nga e para, duke ndjekur procedurat në hyrje të përcaktuar në Rregulloren e këtij programi;

	<p>Tabela 21 në RVB nuk tregon asnjë student të transferuar gjatë viteve akademike të raportuara. Këto elemente u konfirmuan nga GVJ edhe gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Tabelat e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Vendosja, Miratimi dhe Shpallja e Kritereve të Pranimit për MSH Financë-Kontabilitet V.A. 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për të analizuar këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar jo vetëm Planin Mësimor që është pjesë e tabelave të RVB dhe e rregullores së programit të studimit, por edhe programet lëndore përkatëse të programit të studimit MSHFK në UAMD. Referuar këtyre të dhënave GVJ konstaton se syllabusi i cdo lënde përmban kryesisht informacionet e nevojshme të detajuara, në lidhje me orët në auditor dhe orët e studimit individual në përputhje kjo me VKM nr.41. Komponentët formues të programit konstatohet se janë formuluar konform formateve të kërkuara sipas VKM nr. 41 të ndryshuar nga VKM nr. 879.</p> <p>Neni 6 i Rregullores së programit të studimit specifikon se në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, në programin lëndor duhet të jepen në formë të përmbledhur: (i) të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e lëndës, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor, emri i titullarit të lëndës dhe i stafit mësimdhënës; (ii) njohuritë paraprake që duhet të ketë fituar paraprakisht studenti, objektivat formuese të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvetësimi i lëndës, konceptet dhe termat bazë mbi të cilat ndërtohet lënda; (iii) përmbajtja e lëndës, e ndarë në leksione dhe ushtrime/seminare, e detajuar në tematika që zhvillohen sipas javëve mësimore; (iv) përmbajtja e punëve laboratorike, praktikave lëndore, temat e detyrave/projekteve të kursit; (v) forma e kontrollit që do të përdoret, parakushtet e hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse. Me përjashtime të vogla jo materiale, GVJ konfirmon përmbushjen e këtyre kërkesave dhe në përgjithësi përmbushjen nga ana e Institucionit të këtij kriteri.</p>



	<p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Tabelat e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Përmirësimi i programit të studimit është parashikuar në rregulloret kryesore të Institucionit (neni 6, pika 2 e rregullore së programit të studimit; neni 17, pika 2.b e rregullore së njësisë bazë). Sipas pikës 4, neni 7 në rregulloren e programit MSHFK, Plani Mësimor është objekt i rishikimit periodik në përputhje me procedurat e përshkruara në atë të institucionit dhe bazës ligjore në fuqi. Propozimi për ndryshimet deri në masën 20% të përmbajtjes së programeve të studimit, të shprehura në kredite, hartohet nga njësia bazë, shqyrtohet nga Dekanati, miratohet në Senatin Akademik dhe i dërgohen për miratim ministrit përgjegjës për arsimin. Këto ndryshime reflektohen në diplomën e lëshuar për studentët. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Senati Akademik dhe jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik njoftohet ministria përgjegjëse për arsimin e lartë. Kjo procedurë u konfirmua edhe gjatë vizitës në Institucion gjatë diskutimeve me stafin akademik. Tabela 11 në RVB përmbledh ndryshimet që kanë ndodhur në Planin Mësimor të MSHFK krahasuar me programin e licensuar. Konkretisht lënda Sistemet e Informacionit në Kontabilitet është zëvendësuar me lëndën Kontabilitet Aplikativ dhe lënda Ekonomiks Menaxherial është zëvendësuar me lëndën Ekonometri. Në gjykimin e GVJ këto ndryshime janë brenda nivelit 20% dhe janë në kahun e përmirësimit të përmbajtjes së programit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit përmban Planin Mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. Programi ka të dhëna të plota në lidhje me kriteret për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Përmbajtja e programit është në përmirësim të vazhdueshëm sipas një procedure të përshkruar në mënyrë të qartë dhe</i></p>

	<i>transparente në dokumentat bazë strategjike të institucionit. GVJ konfirmon përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Për këtë kriter, GVJ ka shqyrtuar Planin mësimor të programit të studimit MSHFK në rregulloren e programit të studimit, si edhe përmbajtjen e detajuar të veprimtarive formuese dhe akademike të cdo lëndë në kurrikul sic gjenden në dosjen e syllabuseve të programit. GVJ konfirmon përfshirjen në këtë program studimi të disa lëndëve në fushën e financës dhe kontabilitetit që garantojnë kryesisht thellimin e njohurive të marra edhe më herët nga ana e studentëve në studimet në ciklin e parë, si edhe aftësimin profesional të tyre për të garantuar punësimin në pozicione pranë njësive publike dhe private. Gama e njohurive të dhëna është e tillë që mundëson kryesisht edhe vazhdimin e mëtejshëm të studimeve, në rast se ky është një interes i studentëve. Nga tabela 10 në RVB, shihet se organizimi i lëndëve në semestra ofron një balancim të arsyeshëm të njohurive të dhëna dhe progresion drejt rritjes graduale të njohurive dhe aftësive të studentëve, që kulmojnë me praktikën profesionale dhe detyrimet përmblyëse në semestrin e fundit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbljedhese per Aneks_RVB 06.05.2023.docx.pdf</i></p>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore	Sipas nenit 4 të rregullores së programit të studimit, ky i fundit synon formimin e profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën e Financës dhe Kontabilitetit, të cilët do të jenë të aftë të përballen me sfidat kombëtare, por edhe ato globale. Për arritjen e misionit

<p>mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>të tij, gjatë viteve të studimit synohet të ofrohet një bazë e thelluar teorike, aftësim në metodat e kërkimit dhe kualifikim profesional në fushat e financës dhe kontabilitetit. Sipas objektivave të programit, në përfundim të tij, profesionisti i sapo diplomuar mund të ndjekë një karrierë akademike përmes kualifikimeve të mëtejshme dhe/ose përparojë në karrierën e tij në institucione të ndryshme publike/private, kombëtare/ndërkombëtare.</p> <p>Në funksion të qëllimit dhe objektivave formues të synuar në program, studentëve u jepen njohuri në lëndë të ndryshme të financës dhe kontabilitetit përgjatë katër semestrave dhe dy viteve akademike (tabela 10 në RVB; aneksi në rregulloren e programit të studimit). Në total, MSHFK ka 120 ECTS të shpërndara me rregullin:</p> <p>Cdo lëndë e bazë e kategorisë A (formimi i përgjithshëm) – 4 ECTS</p> <p>Cdo lëndë e bazë e kategorisë B (lëndë karakterizuese) – 7 ECTS</p> <p>Cdo lëndë e bazë e kategorisë C (lëndë ndërdisiplinore) – 6 ECTS</p> <p>GVJ vë re një shpërndarje të krediteve mes lëndëve të kategorive të ndryshme, ku lëndët e kategorisë A vlerësohen me vetëm 4 kredite, ato të kategorisë C me 6 kredite dhe lëndët karakterizuese (kategoria B), me 7 kredite. Gjatë vizitës në institucion kjo u argumentua me faktin se lëndët karakterizuese janë më të rëndësishme për dhënien e njohurive në profesion.</p> <p>Një konstatim tjetër i GVJ është përsëritja e disa lëndëve të ofruara edhe në ciklin e parë të studimeve dhe anshmëria drejt lëndëve kontabël e cila u argumentua nga ana e stafit me faktin se shumë lëndë financiare ofroheshin në një tjetër program studimi të ciklit të dytë në UAMD, argument ky që GVJ e konsideron të pamjaftueshëm.</p> <p><i>GVJ sugjeron rishikimin e lëndëve për të përfshirë më shumë lëndë financiare, brenda kufijve të lejuar ligjor për ndryshime.</i></p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 06.05.2023.docx.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në</p>	<p>GVJ shqyrtoi përmbajtjen e detajuar të Planit Mësimor të organizuar sipas veprimtarive karakterizuese (aneksi në</p>

<p>përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>rregulloren e programit të studimit) dhe sipas semestrave (tabela 10 në RVB dhe kurrikula e MSHFK në vite).</p> <p>Përsa i përket strukturës së programit, organizimit në vite akademike dhe semestra, numrit total të krediteve dhe renditjes së lëndëve sipas semestrave, GVJ konfirmon një prani të lëndëve dhe renditje të tyre i cili ndiqet përgjithësisht edhe në programe të ngjashme ndërkombëtare (dhe kombëtare). Nga ana tjetër, numri i krediteve që u është caktuar lëndëve të veprimtarive formuese të ndryshme (kategorive A – E), GVJ rikonfirmon se UAMD ndjek një qasje të ndarjes së pabarabartë të krediteve e cila nuk përputhet me modele të universiteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit, sic vetë Institucioni i ka renditur në dokumentin në DVV: Programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.pdf. Megjithatë, duke qenë se tregohet një vëmendje e shtuar drejt caktimit të numrit më të lartë të krediteve drejt lëndëve karakterizuese.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 06.05.2023.docx.pdf</i></p> <p><i>Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023.pdf</i></p> <p><i>Programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>										
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Përsa i përket ngarkesës totale në auditor, programi MSHFK ka strukturën e mëposhtme (tabela 13 në RVB):</p> <table border="0"> <tr> <td>• Leksione</td> <td>700 orë</td> </tr> <tr> <td>• Seminare</td> <td>350 orë</td> </tr> <tr> <td>• Praktikë profesionale</td> <td>90 orë</td> </tr> <tr> <td>• Diploma</td> <td>24 orë</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td>1.164 orë</td> </tr> </table> <p>Raporti Teori (leksione) / Praktikë (sem+usht+proj+prakt.prof) rezulton 700 orë teori / 464 orë praktikë ose afërsisht 60% / 40%.</p> <p>Pavarësisht kësaj, gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se në përputhje edhe me Statutin e Institucionit (Neni 72, pika 4.c), në UAMD implementohen orë mësimore të integruara (leksione/seminare), ku ndarja mes të dy formave të aktivitetit</p>	• Leksione	700 orë	• Seminare	350 orë	• Praktikë profesionale	90 orë	• Diploma	24 orë	Totali	1.164 orë
• Leksione	700 orë										
• Seminare	350 orë										
• Praktikë profesionale	90 orë										
• Diploma	24 orë										
Totali	1.164 orë										

	<p>didaktik bëhej sipas gjykimit të stafit akademik të angazhuar duke respektuar liritë akademike të tij. Në këtë kontekst, në gjykimin e GVJ është e mundshme arritja e objektivave formuese të cilat sic renditen në rregulloren e programit të studimit, ndër të tjera përfshijnë edhe që “programi ka si objektiv të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore shkencore në disipinat e financës dhe kontabilitetit, por edhe me aftësitë e duhura për t’u integruar në tregun e punës dhe shpalosur njohuritë e fituara dhe zotësinë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, ofrimin e sugjerimeve dhe ideve të reja në këto disiplina.”</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 06.05.2023.docx.pdf</i></p> <p><i>Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023.pdf</i></p> <p><i>Programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombetare Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Duke shqyrtuar dokumentacionin në DVV, haset evidencë për nisma për ndryshim dhe përmirësim në programin e studimit MSHFK qoftë duke shqyrtuar Planin Strategjik të Zhvillimit të Programit të studimit, dhe duke dëshmuar për ndryshimet e bëra në këtë program. Gjithashtu, në RVB për këtë kriter, Institucioni citon studimin e bërë në lidhje me ecurinë e programit, ku si pjesë përbërëse dallohet edhe analiza e informacionit të marrë nga punëdhënësit potencialë të studentëve të diplomuar në këtë program. Edhe analiza e përmbajtjes së syllabuseve tregon se ato përdorin kryesisht literaturë të përditësuar dhe në përputhje me kërkesat e tregut të profesioneve përkatëse, financë dhe kontabilitet, ku ka disa përjashtime jo materiale.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Dosja për hapjen e programit MSc Financë-Kontabilitet, Datë 25.05.2018.pdf</i></p> <p><i>Dosja elektronike e aplikimit për riorganizim për Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2020, 2022.pdf</i></p> <p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2019-2023.pdf</i></p> <p><i>Ecuria e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>

	<i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>GVJ është e mendimit se përmbajtja e programit të studimit MSHFK garanton vetëm <i>kryesisht</i> përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. (Sipas rregullores së programit të studimit synimi i tij është formimi i profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën Financës dhe Kontabilitetit, të cilët do të jenë të aftë të përballen me sfidat kombëtare, por edhe ato globale të cilat direkt apo indirekt kanë impakt në ekonomi.) Mungesa e lëndëve të profilit financë bën që programi të ketë mundësi potenciale për mangësi në formimin e dijeve të një programi të ciklit të dytë. Nga ana tjetër, në dijeninë dhe formimin e GVJ, një nga kërkesat më të rëndësishme për profesionistët e financës dhe kontabilitetit është përballimi i detyrave të tyre me aftësi teknike por edhe me kompetencë profesionale, gjykim të shëndoshë dhe integritet që garanton një nivel të lartë moral dhe etik në trajtimin e situatave kritike.</p> <p><i>Në këtë drejtim, kurrikulës së programit të studimit i mungojnë lëndë që orientohen drejt etikës në profesion dhe GVJ sugjeron shtimin në të ardhmen ose të një lënde specifike në lidhje me Etikën në profesion, ose të kapitujve të dedikuar etikës në ndonjë prej lëndëve ekzistuese.</i></p> <p>Referenca:</p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFKp</i></p>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>GVJ është e mendimit se disa elemente të munguara në përmbajtjen e programit, si lëndë të profilit finance, lëndë të etikës në profesion, apo seminare në një shkallë të kursyer, mund të kenë impakt negativ në nivelin e lehtësisë me të cilën studentët e programit mund të përballen me mundësitë e punësimit apo me studime të tjera të mëtejshme.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 06.05.2023.docx.pdf</i></p>
Konkluzione	<i>Ky program studimi karakterizohet nga lëndë të profilit financë dhe kontabilitet me një përmbajtje e cila ka ndryshuar disa herë</i>


	<p><i>(brenda nivelit të pranueshëm 20%) që nga miratimi i programit, në përpjekje për të përmirësuar përmbajtjen e tij. GVJ gjykon se disa faktorë si: mungesa e disa lëndëve financiare të rëndësishme për formimin e studentëve të profilit financë kontabilitet në ciklin e dytë, mungesa e lëndëve në fushën e etikës në profesion dhe së fundmi, ekzistenca e disa lëndëve (të detyrueshme) që, në opinionin e GVJ, paraqiten jo aq të nevojshme për këtë profil bëjnë që programi të paraqesë nevojën për përmirësim sa më shpejt.</i></p> <p><i>Në bazë të këtyre konstatimeve, si përfundim, emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave të programit të studimit, mundësojnë kryesisht, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve dhe GVJ shprehet për përmbushjen kryesisht të këtij standardi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>RVB e përgatitur nga Institucioni për këtë kriter gjykohet e pamjaftueshme nga ana e GVJ. Për të formuar një mendim, GVJ shqyrtoi fillimisht Rregulloren e programit të studimit ku në nenin 7 (pika 4), parashikohet se plani mësimor i programit MSHFK është objekt i rishikimit periodik në përputhje me procedurat e përshkruara në rregulloret e institucionit dhe sipas bazës ligjore në fuqi. Ndryshimet deri në masën 20% të përmbajtjes së programeve të studimit, të shprehura në kredite, hartohet nga njësia bazë, shqyrtohet nga Dekanati, miratohet në Senatin Akademik dhe i dërgohen për miratim ministrit përgjegjës për arsimin. Këto ndryshime reflektohen në diplomën e lëshuar për studentët. Miratimi i ndryshimeve bëhet nga Senati</p>

	<p>Akademik dhe njoftohet ministria përgjegjëse jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik.</p> <p>Më pas GVJ krahasoi përmbajtjen fillestare të programit të studimit MSHFK dhe ndryshimet e bëra në vijimësi të tij duke konstatuar se program ka pësuar disa ndryshime që ka momenti fillestare, ndryshime që GVJ i gjykon të drejta dhe në drejtim të përmirësimit të cilësisë së programit. Gjithashtu, nga analiza e ecurisë së programit të studimit (dokument në DVV), mund të shihen hapat e bëra nga Institucioni për të përfshirë opinionet e marra nga partnerët dhe palë të tjera bashkëpunëtoare në lidhje me përputhjen më të mirë mes programit dhe kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e programit të studimit MSHFK.</i></p> <p><i>Ecuria e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 06.05.2023.docx.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në DVV, Institucioni ka përfshirë informacione dhe dokumenta që faktojnë përfshirjen e studentëve në struktura institucionale, në procesin e vlerësimit të procesit akademik dhe dhënien e opinioneve për përmirësimin e programit të studimit si analiza e tregut të punës, pyetësori me studentët, përfshirja e studentëve në vendimarrje, dhe raporti Alumni Network. Në lidhje me kontaktet me studentët alumni, përsëri në RVB përfshihen referenca me lidhje të dobët me argumentimin e kriterit përkatës. Megjithatë, përsa i përket shkallës së reflektimit të sugjerimeve të tyre, drejtues të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë dhe stafi akademik i programit u pyetën gjatë vizitës në Institucion duke u shprehur se me studentët e diplomuar organizhen herë pas here takime për të marrë mendimet e tyre tashmë në rolin e të punësuarve në biznese të ndryshme.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Analiza e tregut të punës në hapje të programit MSH në Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Pyetësori i Studentit, si e drejtë e shprehjes se mendimit për kurset e studimit dhe procesin e vlerësimit.pdf</i></p> <p><i>Përfshirja e Studentëve në Vendimarrje-Këshillim-Vlerësim vlerësimin mbi Procesin Akademik, UAMD.pdf</i></p>



	<i>Evidenca 132_Raporti Alumni Network.pdf</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>Duke qenë se RVB për këtë kriter përsëri nuk ofron informacion relevant, GVJ iu drejtua një dokumenti në DVV që shqyrton ecurinë e programit të studimit duke analizuar ndër të tjera edhe opinionin e aktorëve të tregut. Edhe në analizën e marrëveshjeve të departamentit financë kontabilitet ofrohen evidenca që mbështesin bashkëpunimin e njësisë përgjegjëse me rrjete profesionistsh dhe shoqata të profesionit kontabël, që japin kontributin e tyre në drejtim të pasurimit të përmbajtjes dhe rritjes së cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Ecuria e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Analiza e Marrëveshjeve të Departamentit F-K.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ është e mendimit se Institucioni dëshmon përpjekje serioze dhe konsistente në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së programit të studimit MSHFK duke përfshirë në këtë proces edhe studentët, edhe bashkëpunëtorët sidomos rrjete profesionale dhe përfaqësues të tregut në fushën përkatëse, edhe studentët alumni. Në këtë fushë, RVB nuk ishte përgatitur në mënyrë transparente dhe cilësore, megjithatë në DVV ishin përfshirë tërësia e dokumentacionit të nevojshëm. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në	Sic evidentohet nga vendimi i hapjes së tij, programi MSHFK është program i ciklit të dytë, i nivelit të 7-të i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Sipas rregullores së tij, ky program synon formimin e profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën e Financës dhe Kontabilitetit, të cilët mund të jenë të aftë të përballen me sfidat kombëtare. Programi ka si objektiv të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore shkencore në disiplinat e

<p>përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>financës dhe kontabilitetit, por edhe me aftësitë e duhura për t'u integruar në tregun e punës dhe treguar njohuritë e fituara dhe zotësinë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, ofrimin e sugjerimeve dhe ideve të reja në këto disiplina. GVJ gjykon se misioni dhe objektivat e programit të studimit janë në përputhje me Strategjinë kombëtare për teknologjinë, shkencën dhe inovacionin, me Strategjinë për përmirësimin e raportimit financiar në Shqipëri, me Strategjinë për ndërkombëtarizimin e institucionit, dhe me planet strategjike të zhvillimit të UAMD, FB dhe departamentit të FK. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës, 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Fakulteti i Biznesit 2021-2026 dhe 2015-2020.pdf</i></p> <p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Strategjia dhe Plani i Veprimit për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Shoqërive në Shqipëri (2021 - 2024).pdf</i></p> <p><i>Strategjia Kombëtare për Teknologjinë, Shkencën dhe Inovacionin 2017-2021.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UAMD 2019-2021, 2022-2024.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Në përputhje me synimet e njësisë kryesore dhe asaj bazë në planet strategjike respektive si edhe përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi në rregulloret përkatëse, GVJ konfirmon organizimin e kujdesshëm dhe me rregull të aktiviteteve didaktike dhe kërkimore e shkencore të programit të studimit për t'u dhënë anëtarëve të stafit akademik liri dhe nxitje në procesin mësimor. Stafit akademik u shpreh gjithashtu gjatë vizitës në institucion për një atmosferë të mirë bashkëpunimi ku ata ndjeheshin të lirë të shprehnin opinionet dhe të diskutonin rezultatet e punës së tyre.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Fakulteti i Biznesit 2021-2026 dhe 2015-2020.pdf</i></p>



	<p><i>Plani Strategjik i Zhvillimit Dep. Financë - Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Sipas dokumentave në DVV shihet se studentët janë aktivë dhe marrin pjesë në aktivitete të rëndësishme akademike sic janë shkëmbimet në programet Erasmus (tabelat 2 RVB tregojnë për 22 studentë pjesëmarrës nga dhe drejt programit të studimit), pjesëmarrja e tyre në konferenca shkencore studentore dhe publikimi më pas i punimeve të tyre si edhe për angazhim në projekte të tjera (tabela 22 në RVB tregon për 6 studentë të angazhuar në punime shkencore së bashku me pedagogë të programit të studimit), por edhe aktivitete në bashkëpunim me partnerët sic është konkursi i punimeve kërkimore në bashkëpunim me AADF-në.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Pjesëmarrjet në programet Erasmus + Studentët.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 06.05.2023.docx.pdf</i></p> <p><i>Konferenca Studentore në Fakultetin e Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Konkursi i Punimeve Kërkimore – 2 në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Në RVB për këtë kriter jepen disa të dhëna në lidhje me mënyrën e mbështetjes që institucionit tregon ndaj njësisë bazë në lidhje me realizimin e aktiviteteve shkencore. Duke qenë se UAMD jo vetëm ka hartuar një sërë rregulloresh për këtë qëllim (ku listojmë: Rregullore të organizimit të konferencave dhe aktiviteteve shkencore, Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore dhe Rregullore të këshillit të kërkimit shkencor) duke siguruar kuadrin e nevojshëm rregullues për mbarëvajtjen e aktiviteteve të këtij profili, por edhe ka evidencë për financimin e këtyre aktiviteteve dhe mbështetjen e njësisë kryesore (dokumenti “Mbështetja financiare nga UAMD për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore pranë FB). Gjithashtu gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik konfirmoi mbështetjen financiare të Institucionit për aktivitete kërkimore sic ishte botimi i artikujve shkencorë me faktor impakti në Scopus.</p> <p>Referenca:</p>

	<p><i>Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD.pdf</i></p> <p><i>Ngritja e Grupeve të Punës në Projekte, Konferenca, etj, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Menaxhimin e Aktiviteve Kërkimore Shkencore në UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Këshillit të Kërkimit Shkencor, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Mbështetja financiare nga UAMD për realizimin e aktiviteve studimore, kërkimore e shkencore pranë Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 06.05.2023.docx.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Programi i studimit MSHFK është organizuar duke mundësuar, nxitur dhe motivuar studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore si shkëmbime Erasmus, konferenca studimore me caktime të cmimeve inkurajuese për kërkuesit e rinj, punime dhe projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogët e programit. Edhe njësisia bazë dhe stafi akademik mbështeten financiarisht nga Institucioni për të nxitur rezultate sa më të mira të punës kërkimore dhe shkencore. GVJ shpreh opinionin për përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në DVV, ka evidencë për procedurat e menaxhimit të aktiviteve kërkimore dhe shkencore në pothuajse të gjitha etapat e organizimit të tyre. Në dokumentin “Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD”, ndeshen të dhëna të detajuara në lidhje me llojet e veprimtarive shkencore dhe organizatorët. Konferencat dhe veprimtaritë e tjera shkencore organizohen nga njësitë bazë të UAMD që përfshihen në vlerësimin institucional</p>

<p>studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>dhe rankimin periodic dhe integrohen me programet e studimit që ato realizojnë.</p> <p>Në veprimtaritë shkencore marrin pjesë aktivisht edhe studentët, dhe ky fakt u konfirmua nga GVJ edhe gjatë vizitës në Institucion. Njësitë bazë kërkojnë me shkrim mbështetjen e drejtuesit të njësisë bazë dhe/ose kryesore, në rastet kur një mbështetje e tillë është e domosdoshme për realizimin e tyre. Për organizimin e çdo veprimtarie shkencore, drejtuesi i njësisë përkatëse, rakordon me administratën për mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për realizimin e saj.</p> <p>Në Rregulloren e Këshillit të Kërkimit Shkencor, (KKSH) në UAMD përshkruhet mënyra e funksionimit të këtij organi të rëndësishëm në kuadrin e veprimtarisë kërkimore. KKSH harton “Kriteret e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe njësive të UAMD”, të cilat përfaqësojnë një listë treguesish të veprimtarisë kërkimore-shkencore të vendosur në një sistem pikëzimi. Përmes tyre KKSH vlerëson në mënyrë të standardizuar kontributet e njësive bazë të UAMD dhe personelit akademik të tij, monitoron në kohë reale veprimtarinë kërkimore-shkencore, bën vlerësimin periodik dhe rankimin e departamenteve dhe njësive të tjera bazë që përfshihen në vlerësimin institucional. Ndërsa në Rregulloren e menaxhimit të aktiviteteve kërkimore shkencore, janë parashikuar në detaje aspektet që kanë të bëjnë me delegimin e detyrave dhe përgjegjësi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD.pdf</i></p> <p><i>Ngritja e Grupeve të Punës në Projekte, Konferenca, etj, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Menaxhimin e Aktiviteteve Kërkimore Shkencore në UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Këshillit të Kërkimit Shkencor, UAMD.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe</p>	<p>Sipas klauzolave të parashikuara në rregulloret e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD dhe të menaxhimit të këtyre aktiviteteve, përfshirja e stafit dhe e studentëve është e rëndësishme për t’iu përgjigjur në kohë dhe me cilësi përbushjes së studimeve dhe projekteve. Tabelat në RVB (tabela 20) konfirmojnë angazhimin e stafit akademik dhe</p>

<p>angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>studentëve të programit të studimit MSHFK. Numri i pjesëmarrjeve si partnerë në projekte kombëtare ose ndërkombëtare është 6; janë 5 projekte të fituara nga departamenti dhe 12 të fituara nga fakulteti përgjegjës për programin e studimit; janë gjithsej 66 aktivitete shkencore të organizuara në nivel institucional dhe numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete varion nga 150 – 300 pjesëmarrës.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e organizimit të konferencave dhe veprimtarive shkencore në UAMD.pdf</i></p> <p><i>Ngritja e Grupeve të Punës në Projekte, Konferenca, etj, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Menaxhimin e Aktiviteteve Kërkimore Shkencore në UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Këshillit të Kërkimit Shkencor, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Tabelat Master i Shkencave Financë Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Jo vetëm nga ana formale e hartimit të rregulloreve, por edhe nga pikëpamja e plotësimit dhe realizimit të veprimtarive shkencore, paraqitet dokumentim i plotë dhe që fikon aktivitetet e kryera. GVJ ndeshet me një listë të pasur të aktiviteteve shkencore, konferencave dhe takimeve të tjera që ndihmojnë si stafin akademik ashtu edhe studentët e programit të studimit. Leksionet e hapura, trajnimet dhe shkëmbimet në kuadër të marrëveshjeve Erasmus +, aktivitete me përfaqësues të biznesit si shoqata e sigurimeve, mbështetja për punësimin, Deloitte kompani auditimi, etj, janë disa shembuj pozitivë të nxitjes së aktiviteteve në fushën e financës dhe kontabilitetit, ndërgjegjësimit të studentëve në lidhje me çështje të rëndësishme të profesionit por edhe të punëdhënësve të cilët përmes këtyre aktiviteteve vijnë në kontakt me institucionin dhe me studentët.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit.pdf</i></p> <p><i>Trajnime dhe mobilitete Erasmus_PAE.pdf</i></p> <p><i>Pjesëmarrjet në programet Erasmus + Studentët.pdf</i></p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete, Dep. Financë – Kontabilitet Takim për Lidhjen Marrëveshje mes FB dhe Shoqatës së Sigurimeve, 8 Maj 2021.pdf</i></p>

	<p><i>Njoftime, Aktivitete, Dep. Financë – Kontabilitet_ËB6 CSOs for youth Employment Support.pdf</i></p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete, Dep. Financë – Kontabilitet_Njoftim në faqet sociale për Trajnim dhe Punësim Deloitte.pdf</i></p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete, Fakulteti i Biznesit_Panairi i Punës dhe Karrierës në Fakultetin e Biznesit 2022.pdf</i></p> <p><i>Tabelat Master i Shkencave Financë Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Në bazë të Planit Mësimor të programit të studimit dhe syllabuseve përkatëse, me rezervat e shprehura tashmë më lart në këtë raport (standardi II.1 dhe II.4) GVJ shprehet se studentët e diplomuar janë të aftë kryesisht të punojnë në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit. Ata janë konkurrues për këtë treg dhe mund të përshtaten me kërkesat e paraqitura nga punëdhënësi sidomos në fushën e kontabilitetit që paraqet edhe tregun më kërkues për profesionistë ekonomistë, sot për sot në Shqipëri.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>RVB e përgatitur nga Institucioni për këtë kriter shprehet se kriteri nuk ka aplikim për programin e studimit MSHFK. Megjithatë GVJ është në dijeni të kërkesave rregullatore në vend për kompetencat e nevojshme në kuadër të fitimit të licencës së “Kontabilistit të Miratuar” dhe “Audituesit Ligjor” në Shqipëri (nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike), dhe të licensave ndërkombëtare si ACCA, CPA, CIMA, etj. Pikërisht në kuadër të kërkesave për këto certifikime profesionale, kërkesa që vijnë nga rrjete profesionale brenda vendit si Bordi i Mbikëqyrjes Publike, apo jashtë vendit si IFAC (International Federation of Accountants), GVJ parashtroi në standardet më lart (standardi II.4.6) përfshirjen e më tepër lëndëve të aspektit financiar dhe sidomos përfshirje të lëndës, apo qoftë edhe temave të vecanta në fushën e Etikës në Profesion.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në të ardhmen këto kërkesa të organizmave profesionale kontabël dhe financiarë, të shqyrtohen në kuadër të përgatitjes së Raportit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit Master Shkencor në Financë - Kontabilitet.</i></p> <p>Referenca:</p>



	<i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Në gjykimin e GVJ ky kriter nuk gjen aplikim për programin e studimit MSHFK në UAMD.			
Konkluzione	<i>GVJ shqyrtoi dokumentacionin në DVV dhe konfirmon mbështetjen institucionale në kuadër të organizimit të aktiviteteve kërkimore dhe shkencore në formën e hartimit të rregulloreve të posacme, mbështetjes financiare dhe logjistike si edhe krijimit të kushteve për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve dhe stafit të programit të studimit. Numrat e lartë të aktiviteteve shkencore e kërkimore dhe personave pjesëmarrës në to, dëshmon për një politikë të suksesshme të UAMD në këtë drejtim, dhe GVJ mbështet përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxëniet dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ shqyrtoi Rregulloren e programit të studimit (neni 12, pika 2), Planin Mësimor të tij, dhe tërësinë e syllabuseve të lëndëve të ofruara në këtë program studimi duke konstatuar këto forma të mësimdhënies:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Orë mësimi leksionesh; b. Orë mësimi seminaresh; c. Orë mësimi të integruara të leksioneve me seminarët; d. Projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; e. Provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; f. Praktika profesionale e zhvilluar në laboratore të UAMD-së, dhe/ose në institucione dhe kompani me të cilat UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi; Praktikët mësimore realizohen në përputhje me parashikimet e rregulloreve përkatëse. <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua për mënyrën e organizimit të orëve në auditor të cilat ishin orë të integruara leksione dhe seminarë (pika c më lart).</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023.pdf</i></p> <p><i>Tabelat Master i Shkencave Financë Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Sipas Rregulloreve së programit të studimit, parashikohet që gjatë zhvillimit të lëndës të përdoren metoda të ndryshme, duke përfshirë leksionet, mkësim të integruar leksione/seminare, seancat e ushtrimeve dhe diskutimeve, por dhe prezantimi dhe diskutimi i materialeve të marra nga literatura, apo çdo formë tjetër të miratuar nga njësia bazë. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga studentët e programit të studimit për larminë e metodave didaktike të pedagogëve të cilët angazhohen për të përfshirë sa më shumë studentët dhe për t’iu përgjigjur nevojave të tyre. Edhe kushtet logjistike të klasave ishin të mira për të garantuar që personeli akademik të angazhohej në mënyra alternative mësimdhënieje (raste studimore apo lektorë të ftuar dhe aktivitete të tjera të</p>

	<p>organizuara nga njësia bazë) dhe duke përdorur mjete të ndryshme si dërrasa, projektor, etj.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullorja e Programit të studimit MSHFK</i></p> <p><i>Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 34. Metodat interaktive të përdorura për mesimdhëni.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri, GVJ gjykon me rëndësi konfirmimin e përmirësimit të vazhdueshëm të aftësive pedagogjike – didaktike të stafit PAE dhe PAK në UAMD. Gjatë shqyrtimit të DVV, GVJ u gjend para konstatimit se në njësinë kryesore dhe në njësinë bazë që ofrojnë programin e studimit MSHFK ka një nivel të ulët rotacionit të stafit cka dëshmon për kënaqësi të stafit, trajtim dinjitoz dhe mbështetje të tij. Po kështu, GVJ ndesh evidencë për trajnime të vazhdueshme të stafit në kuadrin e marrëveshjeve të shkëmbimit Erasmus +. Nuk u ndesh provë dokumentare për trajnime të ofruara brenda vendit nga ana e Institucionit, përveç trajnimit të ofruar për përdorimin e metodave elektronike të vlerësimit Clean Score, por të pyetur gjatë vizitës në Institucion, stafi u shprehën se ata angazhohen vazhdimisht në trajnime institucionale ku më i fundit ishte trajnimi për metodat kërkimore. Shihet se shumica e stafit PAE kanë ngarkesë mësimore të konsiderueshme, por kjo është brenda normave të parashikuara ligjore dhe përfaqësues të stafit u shprehën se ngarkesa mësimore ishte e menaxhueshme.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Tabelat Master i Shkencave Financë Kontabilitetit.pdf</i></p> <p><i>Trajnime dhe mobilitete Erasmus_PAE.pdf</i></p> <p><i>Ngarkesën Mësimore e Stafit Akademik në V.A 2019-2022.pdf</i></p> <p><i>Trajnime CleanScore.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mesimdhëni në program</p>	<p>Duke shqyrtuar dosjen e CV të personelit akademik efektiv në programin e studimit MSHFK, dosjet e vetë vlerësimit të tyre si edhe dokumenta në DVV si kualifikimet dhe kërkimet</p>

<p>është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>shkencore të PAE gjatë viteve të fundit dhe trajnimet dhe shkëmbimet në kuadrin e projekteve ndërkombëtare Erasmus +, shihet se personeli i angazhuar në këtë program kanë gradat shkencore dhe titujt akademikë të duhur (me përjashtim të pak rasteve me gradën Msc), janë të përgatitur për të ofruar mësim cilësor në fushën e kontabilitetit dhe të financës dhe kanë përputhshmëri mes sfondit të formimit të tyre akademik dhe njohurive të nevojshme për t'u përcuar tek studentët e programit të studimit. Pra GVJ konfirmon se ata janë kompetentë në fushat e tyre.</p> <p>Gjatë procesit mësimor, stafi akademik u shprehën se janë të prirur të nxisin pjesëmarrje dhe nivel të lartë të aktivizimit të studentëve, të zgjojnë tek ata të menduarin kritik dhe gjykimin profesional, aq të rëndësishëm në disiplinat kontabël dhe financiare. Vetë studentët u shprehën se procesi mësimor karakterizohet nga mbështetja dhe orientimi i stafit pedagogjik drejt aftësimit në profesionin e tyre.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>CV-të e lektorëve, Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Dep. Financë - Kontabilitet, V.A 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Kualifikimi dhe kërkimi shkencor i PAE në 5 vitet e fundit.pdf</i></p> <p><i>Trajnime dhe mobilitete Erasmus_PAE.pdf</i></p> <p><i>Përputhja e Formimit me angazhimin për personelin akademik F-K.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nga sa GVJ konstatoi, formoi bindjen së në UAMD studentët bëhen rregullisht pjesë e procesit të vlerësimit të procesit të mësimit dhe të pedagogut nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve sipas modaliteteve të parashikuara në Rregulloren e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sipas kësaj rregulloreje vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet:</p> <p>a. Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht</p>

javën e 13 dhe të 14. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë stafin PAE dhe PAK. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, njërive bazë, si dhe dekanëve përkatës. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ pati mundësinë të verifikojë kryerjen e rregullt të procesit të vlerësimit nga ana e studentëve. Fakte për këtë u gjenden edhe në DVV. Vetë studentët u shprehën për marrje në konsideratë të opinioneve të tyre rregullisht nëpërmjet pyetësorëve pavarësisht se nuk kishin pasur raste ku të evidentoheshin problematika që do të kërkonin edhe reagimin e Institucionit;

- b. Vlerësimi të përgjegjësit të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore. Ky pyetësor zhvillohet në fund të semestrit të dytë, brenda muajit Qershor, dhe së bashku me vlerësimin e studentëve i vihet në dispozicion Rektoratit. Në lidhje me këtë mënyrë të vlerësimit, nuk u gjet evidencë në DVV por gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se stafi akademik vlerësohej nga drejtuesi nëpërmjet një komisioni i cili vizitonte pedagogët e përzgjedhur rastësisht gjatë procesit të mësimi në auditor;

Cfarë u konstatua në DVV ishin edhe formularët e vetë-vlerësimit të stafit akademik (që nuk përmenden në Rregullore). Gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik dhe NJSBC konfirmuan mënyrën e vlerësimit të stafit nëpërmjet formularëve të vetëvlerësimit si një ndër instrumentet e vlerësimit të procesit mësimor.

Referenca:

Rregullore e Njesisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf

Përfshirja e Studentëve në Vendimarrje-Këshillim-Vlerësim vlerësimin mbi Procesin Akademik, UAMD.pdf

Pyetsori i Studentit, si e drejtë e shprehjes se mendimit për kurset e studimit dhe procesin e vlerësimit.pdf

Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Dep. Financë - Kontabilitet, V.A 2020-2021.pdf

Vizita në Institucion

Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.

Sipas të dhënave të evidentuara në DVV, UAMD ka ngritur struktura të posacme për kontrollin dhe garantimin e cilësisë në nivel institucional dhe në nivel të njësisë kryesore:

Në nivel Institucional:

- Senati Akademik
- Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC)
- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC)
- Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL)
- Drejtorja e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC)

Në nivel Fakulteti:

- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC) Fakulteti)
- Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program
- Koordinatorët e Programeve të studimit.

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD. KPGSC, në rolin e një komisioni të përhershëm, kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit nga NjSBC. Kjo e fundit, ka si funksion kryesor bashkëpunimin me, dhe asistimin e këtij Komisioni. KPGSC mbikqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. GVJ konfirmoi gjatë vizitës në Institucion këto struktura të ngritura pranë UAMD. Gjithashtu në dokumentin "Ecuria e programit të studimit MSHFK" shihet një analizë e mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit. U verifikua gjithashtu që bëhen trajnime për stafin në kuadrin e marrëveshjeve të shkëmbimit Erasmus +.

Referenca:

Rregullore e Njesisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf

	<i>Ecuria e Programit të Studimit Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet.pdf</i>			
Konkluzione	<i>GVJ arrin në konkluzionin se ky standard përmbushet plotësisht pasi Institucioni organizon struktura në nivel institucional dhe edhe në nivel njësie kryesore që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Studentët përfshihen në procesin e vlerësimit të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>UAMD ka hartuar rregullore në nivel institucional, njësie kryesore, dhe programi studimi, ku në të gjitha ato specifikohen kriteret e vlerësimit të njohurive të studentëve. Këto rregullore parashikojnë që në programin MSHFK, për të vlerësuar njohuritë e studentit, përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit. Nota minimale kaluese është 5 (pesë). Shkalla e përvetësimit të programit mësimor të lëndës vlerësohet me një sistem pikëzimi 1000 pikësh i cili konvertohet në notë në proces-verbalin përfundimtar. Forma e kontrollit të dijeve për lëndët/modulet mësimore është provimi me shkrim. Për çdo lëndë 10% e vlerësimit bazohet në detyra kursi, ese, projekte individuale dhe në grup, sipas programit të miratuar të lëndës; 40% e vlerësimit bazohet në një provim të ndërmjetëm dhe 50% e vlerësimit bazohet në provimin përfundimtar. GVJ konfirmon që studentët janë të njohur me këtë mënyrë vlerësimi e cila, në përputhje edhe me kërkesat rregullatore në fuqi, është e përfshirë në syllabuset e cdo lënde.</p> <p>Referenca:</p>

	<p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit (neni 53) mund të shihet se është parashikuar që në orën e parë të zhvillimit të lëndës, të prezantohen dhe t'u shpjegohen studentëve nga lektori, syllabusi (programi lëndor), rregullat e provimit dhe mënyra e vlerësimit dhe përqindja përkatëse në frekuentim, aktivizimi gjatë gjithë semestrit, prezantimi dhe mbrojtja e detyrës së kursit dhe cdo detyrim tjetër që mund të lidhet me lëndën. Gjithashtu, edhe rregullat e përgjithshme të funksionimit të Universitetit qartësohen nga lektori në orën e parë të prezantimit. Studentët e programit MSHFK e konfirmuan për GVJ këtë praktikë të zakonshme të organizimit të orëve mësimore në UAMD dhe u shprehën se kjo ishte një ndër elementët me të cilën ata fillonin të gjitha lëndët e reja të studimeve të tyre.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Sic konfirmohet nga rregullorja e njësisë kryesore, në programin MSHFK në UAMD për çdo lëndë, 10% e vlerësimit bazohet në detyra kursi, ese, projekte individuale dhe në grup, sipas programit të miratuar të kursit; 40% e vlerësimit bazohet në një provim të ndërmjetëm dhe 50% e vlerësimit bazohet në provimin përfundimtar. Një përmbledhje e kësaj forme vlerësimi është dhënë edhe në tabelat e RVB. Në gjykimin e GVJ shpërndarja e paraqitur e formave të vlerësimit jep mundësi që studenti të shprehë njohuritë dhe kompetencat e fituara në mënyra të ndryshme, si me gojë (detyra kursi dhe diskutime në klasë), ashtu edhe me shkrim (provime). Nëse do të bëhej një përmirësim i mënyrës së vlerësimit, në opinionin e GVJ, ai do duhej të ishte në kontekstin e shtimit të peshës së vlerësimit nga komponentë të tjerë të ndryshëm nga provimet</p>

	<p>(të cilat në strukturën aktuale të vlerësimit japin 90% të pikëve totale të vlerësimit të studentit). Megjithatë, kjo ngelet një element për të cilin qasja aktuale ka rezultuar e sukseshme deri më tani dhe nuk ka argument objektiv (vec opinionit të GVJ) për ndryshimin e tij.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Tabelat Master i Shkencave Financë Kontabilitet.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në programin e studimit MSHFK në UAMD ka rregulla të qarta të vlerësimit të studentëve të cilat përfshihen në kuadrin rregullator të brendshëm të Institucionit, në programet lëndore, dhe u bëhen me dije studentëve në fillim të çdo lënde/moduli. Mënyra e vlerësimit është e diversifikuar mes disa formave të vlerësimit (me shkrim dhe me gojë) duke mundësuar që studentët të shfaqin aftësitë e tyre në mënyra të larmishme dhe është e shtrirë përgjatë gjithë semestrit. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton se syllabuset e çdo lënde, të cilat hartohen nga lektori përgjegjës jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara fillimit të semestrit, dhe miratohen tek Përgjegjësi i Departamentit përkatës kanë të përhurë mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të studentëve. Vlerësimi përfundimtar i çdo lënde kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë: a) Provimi i parë i ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë dhe/ose të tetë të semestrit, përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar; b) Provimi përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë dhe/ose të gjashtëmbëdhjetë të semestrit, përmban 500 pikë ose 50% të</p>

	<p>vlerësimi përfundimtar; c) Detyrat, projektet, esetë, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit, aktivizimi gjatë orëve të mësimi, përmbajnë 100 pikë ose 10% e vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Sipas kësaj shpërndarjeje, studentët fitojnë të paktën 50% të pikëve totale (10% nga detyrat dhe projektet përgjatë semestrit dhe 40% nga provimi i ndërmjetëm në javën e shtatë ose të tetë) gjatë vitit akademik, cka zvogëlon varësinë nga një vlerësim i vetëm në një moment të caktuar dhe ul riskun e performancës së dobët nga ana e studentëve.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimi, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në RVB të Institucionit për këtë kriter përmendet përdorimi i metodave elektronike të vlerësimi sic është CleanScore i cili jep mundësi të korigjimeve elektronike në kushte anonimatit cka mundëson transparencë dhe siguri të shtuar. Përdorimi i kësaj metode, u konfirmua nga GVJ edhe gjatë diskutimeve me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi. Aktualisht nuk përdoren metoda të korigjimit anonym të provimeve, pavarësisht se në të shkuarën janë përdorur metoda të gjenerimit të barkodeve unike.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Trajnime CleanScore.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ, gjatë diskutimeve me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit MSHFK në UAMD konfirmoi që ata ndiqnin në mënyrë rigorozë vlerësimin përfundimtar në përputhje me syllabusin e lëndës, dhe këto të fundit (nga analiza e kryer nga GVJ) janë në përputhje me bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>

<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Sipas Rregullores së provimeve në Fakultetin e Biznesit në UAMD korrigjimet e tezave kryhen gjithmonë me ngjyrë të dallueshme, e ndryshme nga ajo e tezës së studentit. Teza duhet të përmbajë domosdoshmërisht pikët sipas vlerësimit të grup-pyetjeve, si dhe pikët totale, të vendosura në pozicion të dukshëm brenda tezës. Gjithashtu, në rastet e provimeve të ndërmjetme, ato sqarohen në orën pasardhëse të mësimit dhe bëhet ballafaqimi i rezultateve në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të personelit akademik të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Të pyetur gjatë vizitës, stafi akademik dhe studentët e programit të studimit konfirmuan këto modalitete të vlerësimit të njohurive të cilat parashikohen në rregulloren përkatëse.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Rregullorja e Provimeve në Fakultetin e Biznesit në UAMD parashikon disa rregulla për kryerjen e provimit ndër të cilat edhe disa procedura që synojnë të shmangin dhe zvogëlojnë mundësinë e plagjiaturës/kopjimit. Këto elemente të përfshira në rregullore listohen si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës; 2. Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi; 3. Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës; 4. Personeli akademik informon studentët për materialet që ata mund të përdorin përpara fillimit të provimit; 5. Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës. Gjithashtu procesverbalit i bashkëngjitet provimi i cili vlerësohet me 0 pikë; 6. Në përfundim të çdo sezoni provimesh ose riprovimesh sekretaria mësimore dërgon pranë Zv.Dekanit mësimor listën e studentëve të penalizuar. Dekani, bazuar në parregullsinë e konstatuar merr një vendim mbi masat e

	<p>mëtejshme disiplinore që do të zbatohen rast pas rasti bazuar në shkeljet e konstatuara;</p> <p>Gjithashtu, Rregullorja e provimeve kërkon që tezat të përgatiten në 4 kopje, një element ky, që në gjykimin e GVJ, minimizon mundësitë e abuzimit me kopje në provim.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas Rregullores së provimeve, e cila mbështetet në Rregulloren e njësisë kryesore (FB), në rastin e provimit përfundimtar personeli akademik i lëndës cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të mësipërme. Gjatë vizitës në Institucion u konfirmuan këto rregulla të nxjerrjes së rezultateve.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në disa prej rregulloreve të brendshme të UAMD dhe të njësisë kryesore, parashikohen të drejtat që kanë studentët për t'u njohur me vlerësimin dhe për ta ankimuar atë. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin që i është dhënë. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Kjo procedurë e parashikuar në rregulloret institucionale, u konfirmua se ndiqej nga stafi akademik i programit të studimit dhe edhe studentët e konfirmuan se ata kishin mundësi të shihnin vlerësimet e marra në provimet e lëndëve dhe se stafi u shpjegonin elementet ku kishin gabuar në provim.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>



<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p>Rregullorja e njësisë kryesore dhe Rregullorja e provimeve në UAMD parashikojnë me detaje dhe në mënyrën të plotë modalitetet, afatet dhe hapat që ndiqen në rastin e procedurës së ankimimit të vlerësimit nga ana e studentit.</p> <p>Ankimimi i studentit duhet të formulohet me shkrim dhe t'i drejtohet Drejtuesit të Njësisë Kryesore jo më vonë se 3 ditë kalendrike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i Njësisë Kryesore kur e sheh të arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës dhe pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te Drejtuesi i Njësisë Kryesore një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit Drejtuesi i Njësisë Kryesore vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit. Në rastin kur kërkesa refuzohet studentin njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Përgjegjësi i Departamentit përcakton ditën dhe orën se kur do mbledhet komisioni ad-hoc jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës dhe njofton për këtë orar personelin akademik të seksionit dhe studentin. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të seksionit nëse këta paraqiten në orarin e përcaktuar. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Këto procedura u konfirmuan nga GVJ gjatë vizitës në Institucion.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në UAMD procedura e organizimit të provimeve dhe e vlerësimit të njohurive të studentëve është e rregulluar dhe zbatohet në përputhje me çfarë është parashikuar në rregulloret institucionale. Studentët informohen në lidhje me vlerësimin e tyre dhe mangësitë që kanë sjellë rezultatin përkatës dhe kanë të drejtën të ankimojnë këtë vlerësim. Procedura e ankimimit të vlerësimit është e parashikuar në rregullore dhe ndiqet në tërësi. Në përfundim të procedurës,</i></p>

	<i>dokumentacioni arkivohet në sekretarinë mësimore. GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Sipas rregullores së programit të studimit Programi MSHFK synon formimin e profesionistëve dhe studiuesve të rinj në fushën Financës dhe Kontabilitetit, të cilët do të jenë të aftë të përballen me sfidat kombëtare, por edhe ato globale të cilat direkt apo indirekt kanë impakt në ekonomi. Për arritjen e misionit të tij, gjatë viteve të studimit, program synon të ofrojë një bazë të thelluar teorike, aftësim në metodat e kërkimit dhe kualifikim profesional në fushat e financës dhe kontabilitetit. Programi ka si objektiva të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore shkencore në disiplinat e financës dhe kontabilitetit, por edhe me aftësitë e duhura për t'u integruar në tregun e punës dhe shpalosur njohuritëe fituara dhe zotësinë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, ofrimin e sugjerimeve dhe ideve të reja në këto disiplina. Mesa GVJ gjykon nga tërësia e lëndëve në Planin Mësimor dhe përmbajtja e syllabuseve të tij, programi arrin kryesisht të ofrojë thellim të njohurive akademike dhe shkencore të studentëve.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Programi i studimit MSHFK ka parashikuar lëndë dhe module që synojnë aftësimin e studentëve në njohuri teknologjike në fushën e financës dhe kontabilitetit (sistemet e informacionit kontabël dhe kontabiliteti aplikativ), ndërsa për aftësitë e tjera të

<p>informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>kërkuara në këtë kriter (aftësi në fushën humane, sociale, komunikimi dhe ndërveprimi), GVJ gjykon se disa prej tyre (p.sh, komunikimi) mund të përftohen në mënyrë indirekte nga përdorimi i literaturës shtesë në gjuhë të huaj (raste studimore dhe projekte kursi), dhe përgatitja dhe prezantimi i detyrave të kursit që nxisin punën në grup, dhe përmirësimin e komunikimit profesional dhe ndërveprimit në komunitet.</p> <p><i>Përsa i përket aftësive humane dhe sociale, GVJ qëndron me opinionin e shprehur edhe më herët në këtë raport se do të ishte vlerësuese përfshirja e lëndës, apo e temave në fushën e Etikës në Profesion cka do të nxiste të menduarin kritik të profesionistëve kontabël të ardhshëm dhe do t'i edukonte ata me zgjedhjet e duhura për t'u bërë në raste kritike në punën e tyre.</i></p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Në përputhje me Rregulloren e programit MSHFK në UAMD dhe sic parashikohet edhe në syllabuset përkatëse, java e fundit e semestrit dedikohet për të bërë një përmbledhje të njohurive të shpjeguara përgjatë semestrit. Duke qenë se në mes të semestrit bëhet edhe një provim i ndërmjetëm, GVJ u informua nga studentët e programit të studimit se kjo përmbledhje e njohurive e kërkuar nga ky kriter, ofrohej edhe para provimit të ndërmjetëm. Gjatë përmbledhjes dhe përsëritjes së njohurive kyce, pedagogët japin informacion në lidhje me detyrimet përmblyëse të lëndës dhe studentët kanë të drejtë të pyesin dhe të sqarohen në lidhje me paqartësi të fundit që mund të kenë. Kjo procedurë u konfirmua edhe nga studentët gjatë vizitës së GVJ në Institucion.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion.</i></p>

<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Gjatë diskutimeve me stafin e angazhuar në programin e studimit MSHFK në UAMD, GVJ formoi përshtypjen se ata ishin të angazhuar që të realizonin një proces mësimor serioz dhe të orientuar nga përfitimi i kompetencave në favor të studentëve. Përdorimi i burimeve logjistike të Institucionit, si laboratorët dhe bibliotekat (fizike dhe online) ishin instrumente që stafi i përdorte për të nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve. Puna në grup mbështetej dhe inkurajohej. Stafi akademik mundahej të nxiste studentët duke u dhënë raste studimore edhe nga praktika në terren, edhe nga zhvillimet në botë dhe mundahej të ndërthurte teorinë dhe praktikën duke u mbështetur në bashkëpunimet me institucionet partnere dhe duke ilustruar me shembuj konkret cdo concept që gjykohej i vështirë për t’u kuptuar nga studentët.</p> <p>Vetë Institucioni në DVV ka përfshirë një dokument ku listohen metodat interaktive të mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik i angazhuar në programin MSHFK. Klasifikimet e metodave interaktive janë siguruar bazuar në kërkime empirike dhe sic shihet, pedagogët bëjnë përpjekjen maksimale të përdorin leksione të zgjeruara, pyetje dhe diskutime, shkrimin në klasë, debate, mësimdhënie të bazuara në kompjutera, etj.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Metodat Interaktive të Mësimdhënies.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në DVV institucioni siguron mjaft shembuj të aktiviteteve të organizuara nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë si seminare në lidhje me zhvillime të reja në financë kontabilitet, leksion të hapur mbi Financat - Historia dhe risqet aktualisht potenciale, leksion mbi Pagesat digjitale; QR Code Payments, Leksion i Hapur "Procesi i Fiskalizimit", Leksion i hapur me ekspertë të bankave të nivelit të dytë për temën: "Kreditimi dhe sfidat e tij gjatë pandemisë", Leksion i hapur me ekspertë të bankave të nivelit të dytë për temën: "Siguria Kibernetike ne boten digjitale. Disa keshilla per blerje te sigurta ne internet, workshop 1-Ditor "Menaxhimi i riskut të kredisë post COVID-19, workshop mbi Metodologjinë e Kërkimit. Bazat e metodologjisë kërkimit për punimin e mikrotezës dhe përdorimi i Excelit për statistikën përshkruese. Programet statistikore SPSS apo E-vieë, kur shërbejnë dhe si mund t’i përdorim, etj.</p>

	<p>Referenca:</p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete_Dep. Financë – Kontabilitet_Kalendari i Aktiviteteve Shkencore, Kulturore, Sociale etj.V.A. 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete, Dep. F-K, Drejt një rrugë që sa ka nisur, praktika dhe kërkimi, roli tyre në rritjen profesionale.PDF</i></p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete, Dep. Financë – Kontabilitet_Takim për Lidhjen Marrëveshje mes FB dhe Shoqatës së Sigurimeve, 8 Maj 2021.pdf</i></p> <p><i>Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Në rregulloren Institucionale (nenet 32, 24, 35) parashikohen disa të drejta themelore të studentëve në lidhje me dimensionin kërkimor shkencor të jetës së tyre në UAMD. Studentët konsiderohen si subjekte që kanë të drejtë të kryejnë veprimtari kërkimore dhe shkencore së bashku me pedagogët e programeve përkatëse, njësinë kryesore dhe njësinë bazë. Ata kanë të drejtën të kenë revistat e tyre shkencore në nivel institucioni ose njësie kryesore dhe në pamundësi të kësaj, kanë të drejtë të kenë hapësirat e tyre në revistën shkencore të njësisë kryesore ku po ndjekin programet e studimit.</p> <p>Sipas Rregullores së njësisë kryesore (neni 32), studentët kanë të drejtë të aplikojnë për mbështetje financiare pranë institucioneve kombëtare apo ndërkombëtare për realizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore si dhe krijuese. Gjithashtu, në këtë kontekst, të nxitjes së aktivitetit kërkimor dhe shkencor tek studentët dhe mbështetja financiare e tyre, në Rregulloren e programit të studimit (neni 15) janë parashikuar edhe shkëmbimet studentore sipas së cilës studenti ka të drejtën të aplikojë për shkëmbime studentore në të paktën një semestër pranë një universiteti pritës sipas thirrjeve që shpallen nga Drejtoria e projekteve e cila përzgjedh kandidati/tët fitues.</p> <p>Edhe në tabelat e RVB (tabela 22) shihet se studentët e programit MSHFK janë të përfshirë në projekte shkencore në rang fakulteti dhe departamenti dhe punime shkencore individuale së bashku me pedagogët përkatës. Gjatë vizitës në Isntitucion GVJ konfirmoi këto të dhëna me stafin dhe studentët</p>



	<p>e programit të studimit dhe madje u informua se pjesëmarrja e studentëve në konferencat shkencore ndërkombëtare të organizuara nga UAMD shoqërohej me dhënien e cmimeve për punimet më të mira.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p> <p><i>Tabelat Master i Shkencave Financë Kontabilitet.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Në programin e studimit MSHFK mësimdhënia kryhet në bazë të kompetencave dhe në mënyrë interaktive. Personeli akademik nxit punën në grup dhe aftësitë shkencore dhe kërkimore tek studentët e programit. Stafit angazhon lektorë të ftuar që ndajnë informacione dhe risi nga zhvillimet e reja në fushën e financës dhe kontabilitetit. Në të gjithë procesin, studentët nxiten dhe inkurajohen të bëhen pjesë e procesit cilësor didaktik dhe shkencor.</i></p> <p><i>Programi i studimit MSHFK ofron njohuri të fushës teknologjike por më pak të fushës humane dhe sociale dhe <u>GVJ sugjeron shtimin (qoftë edhe si lëndë me zgjedhje, ose kapituj brenda një lënde ekszituese) të Etikës në Profesion.</u></i></p> <p><i>GVJ mbështet përmbushjen kryesisht të këtij standardi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	Sipas kurrikulës së programit MSHFK në UAMD, si detyrim përmbyllës i studimeve parashikohet punimi i mikrotezës e cila vlerësohet me 12 kredite. Në DVV gjendet Rregullorja e

<p>realizimit të tyre dhe i bën ato publike</p>	<p>mikrotezës për Masterin e Shkencave në Fakultetin e Biznesit në UAMD. Kjo rregullore është hartuar në mënyrë të posacme për të rregulluar shlyerjen e detyrimeve të fundit të studentëve para diplomimit të tyre dhe mbështetet në dokumentacionin e brendshëm institucional sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Statutin e UAMD-së; • Rregulloren e Përgjithshme të UAMD-së. • Rregulloren e Fakultetit të Biznesit. <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Kurrikula Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet 2018-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në Rregulloren e mikrotezës për MSHFK parashikohet se institucioni dhe njësia kryesore dhe bazë orientojnë studentët në lidhje me procedurat dhe afatet që ata duhet të respektojnë në drejtim të përmbushjes së këtij detyrimi. Departamentet përcaktojnë listën e temave të diplomave në fillim të semestrit të parë të vitit akademik. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon Departamenti. Drejtuesit e tezave të diplomës propozohen nga Njësia Bazë dhe miratohen nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore. Puna për realizimin e tezës së diplomës realizohet nga studentit dhe nën udhëheqjen e pedagogut. Udhëheqësi shkencor duhet të këshillojë dhe të mbikëqyrë punën e studentit sipas standardeve metodologjike të kërkuar. Sipas RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter, studentët njoftohen vazhdimisht në mënyrë elektronike por edhe në auditor, në lidhje me procedurat dhe afatet e përgatitjes së punimit të diplomës. Gjithashtu, GVJ hasi praninë edhe të dokumentacionit mbështetës në ndihmë të studentit, si formulari i propozimit të temës së diplomës, draft struktura e propozuar dhe kriteret e vlerësimit të cilësisë së punimit të temës së diplomës.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit, detyrimet përmbyllëse për programin e studimit MSHFK në UAMD</p>



<p>provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>parashikojnë vetëm përgatitje të punimit të diplomës dhe jo provim final. Pra ky kriter nuk ka aplikim për këtë program studimi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit MSHFK dhe në rregulloren e njësisë bazë parashikohet se studenti e zhvillon mikrotezën e diplomës nën drejtimin e një udhëheqësi të miratuar, të cilin ka të drejtë ta propozojë dhe kërkojë vetë. Udhëheqësi i tezës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studenti. Udhëheqësi duhet të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së tezës. Udhëheqësi shkencor duhet të këshillojë dhe të mbikqyrë punën e studentit sipas standardeve metodologjike të kërkuara.</p> <p>Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës. Pasi studenti përfundon shkrimin e tezës, me dakortësinë e udhëheqësit ai depoziton tre kopje të saj në sekretarinë mësimore, bashkë me dy kopje në versionin elektronik. Dorëzimi shoqërohet me vlerësimin me pikë nga Udhëheqësi i Studentit. Materiali përfundimtar, në kopje fizike dhe version elektronik, dorëzohet në sekretarinë mësimore dy javë përpara ditës së shpallur për mbrojtjen publike të punimit. Komunikimi elektronik mes pedagogëve dhe studentëve për udhëzimin e këtyre të fundit gjendet edhe si evidencë në DVV.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>

	<i>Email Orientues rreth Praktikës dhe Mikrotezës_Lektori Udhëheqës.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<p>Në RVB të përgatitur nga Institucioni për këtë kriter cilësohet mbështetja që u jepet studentëve në procesin e përgatitjes së punimit të diplomës. Studentët kanë të drejtë të përdorin laboratorët në Institucion dhe qasjen në bibliotekat elektronike si JSTOR, platforma online Koha (sipas tabelave në RVB), dhe sistemi Cobiss, dhe U library (ebSCO). Gjatë vizitës në Institucion, stafi akademik i programit të studimit konfirmoi mbështetjen që u jepej studentëve konform nevojave që ata hasnin gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës. Po kështu edhe studentët konfirmuan mbështetjen e vazhdueshme nga pedagogët drejtues.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Abonim në librarinë digjitale JSTOR në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF.pdf</i></p> <p><i>Tabelat Master i Shkencave Financë Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	<p>Sipas Rregulloreve të Mikrotezës në MSHFK vlerësimi i tezës së diplomës bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti përkatës dhe miratohet nga Dekani. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 anëtarë. Komisioni për programet e Masterit Shkencor duhet të jetë të paktën me gradë shkencore. Mbrojtja përpara komisionit është e hapur dhe studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij, në jo më pak se 10 minuta. Anëtarët e komisionit dhe dëgjuesit në sallë, rezervojnë të drejtën për t'i drejtuar pyetje studentit në lidhje me tezën e diplomës. Vlerësimi përfundimtar i tezës llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe	Konform kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015 dhe në përputhje me Rregulloren e programit të studimit, MSHFK, studimet përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të

<p>suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>tyre lëshohet diplomë “Master i Shkencave në Financë-Kontabilitet”. Diploma shoqërohet me suplementin e diplomës i cili hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Forma dhe specifikat e suplementit të diplomës përcaktohen në rregulloren e UAMD, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. GVJ konfirmoi këto elemente dhe shprehet për përmbushjen e plotë të këtij kriteri.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas konfirmimit të GVJ, sekretaria mësimore mban në mënyrë të rregullt informacionet për studentët si të dhëna të përgjithshme në lidhje me ta që nga momenti i fillimit të studimeve si formularët e regjistrimit, kopje e dokumentit ID, kontrata e lidhur me studentët, ashtu edhe evidenca gjatë studimeve si evidencat për vlerësimet dhe notat, etj. Këto dokumente ishin në dispozicion të studentëve sipas kërkesave të tyre.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>MSHFK parashikon si detyrim përmblylëse përgatitjen e punimit të diplomës. Punimi i diplomës është individual dhe punohet në udhëheqjen shkencore të një pedagogu me eksperiencë dhe gradë shkencore. Gjatë punës, studenti asistohet nga pedagogu udhëheqës. Në përfundim të procesit të diplomat studentit pajiset me diplomë “Master i shkencave në Financë Kontabilitet Financë” si edhe me suplementin e diplomës. Të gjitha dokumentat në lidhje me student depozitohen në sekretarinë mësimore dhe u konfirmuan nga GVJ. Bazuar në këto elemente që u verifikuan edhe për shkallën e realizimit të tyre gjatë vizitës në Institucion, GVJ shprehet për përmbushjen e plotë të këtij standardi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N/A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N/A
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N/A
Konkluzione	N/A

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1				
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në dokumentacionin shoqërues të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton që personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit MSHFK ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore. Nga dokumentacioni, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar për periudhën 2019- 2022 është si më poshtë:			
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2019-2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 18 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 6 PAK (66.6% /33.4 %); 2. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 22 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 11 PAK (50 % /50 %); 3. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 15 PAE dhe 5 PAK (75 % / 25 %); 			
	Tituj/grada	2019 - 2020	2020 - 2021	2021 - 2022

	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:
Prof.Dr	-	-	-	1	2	-
Prof.As.Dr	3	1	3	2	1	1
Dr/PhD	8	2	7	5	10	-
Msc	1	3	1	3	2	4
Në total	12	6	11	11	15	5

Gjithashtu, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij por vihet re se përkundër kërkesave ligjore në fuqi, në këtë program studimi angazhohen edhe staf akademik me titullin Msc.

Për vitin 2022- 2023 në të dhënat e dorëzuara dhe shqyrtuara nga GVJ, programi nuk ka paraqitur të dhëna mbi stafin mësimdhënës vetëm për programin po në tërësi për Departamentin. Për më tepër, GVJ konstatoi mospërputhje të numrave të personelit tek tabelat.

Referenca:

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat

CV e stafit akademik të programit të studimit.pdf

Statistika, Programi Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf

Shkresë Nr. Prot 31 Datë 25.01.2022_Fushat kërkimore shkencore për Dep. Financë – Kontabilitet.pdf

Ngritja e grupeve mësimore-kërkimore Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf

Vizita në Institucion

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në dy vitet e fundit akademike (sipas të dhënave të tabelës 12 në RVB) jepet në vijim dhe nuk është në përputhje me kërkesat sipas legjislacionit në fuqi pasi stafi PAE nuk mbulon të paktën 70% të ngarkesës mësimore në auditor.

Orë mësimore	Programi i Studimit Msc në Financë Kontabilitet
---------------------	--

	PAE	PAK	Totali
2020 - 2021	675 orë (64%)	375 orë (36%)	1.050
2021 - 2022	675 orë (64%)	375 orë (36%)	1.050

Nga sa më sipër rezulton që për 2 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, nuk është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.

GVJ rekomandon që përballimi i ngarkesës mësimore të PS Master i Shkencave “Financë Kontabilitet” të realizohet në masën mbi 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.

Referenca:

*Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Tabelat
Ngarkesën Mësimore e Stafit Akademik në V.A 2019-2022.pdf
Vizita në Institucion*

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Referuar DVV, RVB dhe gjithashtu vizitës në institucion GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin MSHFK dhe Departamentin Financë Kontabilitet. Punësimi i stafit është në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Ndryshimi i konstatuar në stafin akademik efektiv rezulton më pak se 5%.

Referenca:

*Model Kontrate Pune - UAMD.pdf
Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 2004-2023.pdf
Vizita në Institucion*

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që

RVB dhe dokumentacioni i DVV paraqet qartë procedurën e rekrutimit të stafit me kohë të plotë. Njësia bazë përcakton kriteret të cilat përcillen dhe miratohen nga Drejtuesi i saj, më pas përcillen në Rektorat. Rregullorja për Rekrutimin e Stafit përcakton qartë procedurën që ndiqet në vlerësimin e

<p>garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>kandidatëve në konkurim, si dhe rregullat për përbërjen dhe përzgjedhjen e komisionit <i>ad hoc</i> që drejton konkursin për vendin e lirë të punës. Njoftimet publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe gjithashtu në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf, Neni 103</i></p> <p><i>Statuti i UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Procedura e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë pranë Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Shkresa nr.1318.2 prot datë 22.10.2020 Ngritja e Komisioneve ad-hoc për Rekrutimin e Personelit, FB.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që Fakulteti i Biznesit ka staf ndihmës për departamentin duke përfshirë dhe asistenten e angazhuar në punët administrative. Gjithashtu pjesë e stafit ndihmës për realizimin e orëve laboratorike janë dhe dy laborantë të cilët asistojnë në ambjentin e laboratorit, i cili përdoret nga stafi akademik i Departamentit të Financë Konatbilitetit gjithashtu.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Vendimi Nr.30-2018 dhe 8-2023, Struktura analitike të punonjësve buxhetorë të UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion që UAMD, me përgjegjës Drejtorinë e Burimeve Njerëzore mbledh dhe përditëson cdo vit akademik të dhënat e stafit të angazhuar në programin MSHFK. Dy dosje rastësore të personelit u verifikuan dhe GVJ konstatoi plotësinë e tyre në përputhje me formatin e miratuar. Të dhënave të përditësuara të personelit u bashkangjiten dhe të dhënat e aktiviteti shkencorë dhe akademik referuar formularëve të vetvlerësimit të cilët vlerësohen dhe nga Drejtuesi i njësisë bazë, duke hartuar një analizë vjetore.</p> <p>Referenca:</p>

<p>anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p><i>Statuti i Universitetit _Aleksandër Moisiu_ Durrës.pdf</i></p> <p><i>Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Dep. Financë - Kontabilitet, V.A 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi që UAMD në nivel institucioni por edhe Fakulteti i Biznesit dhe vetë Departamenti i Financë Kontabilitetit kanë marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera, institucione dhe organizata biznesi të cilat ndihmojnë dhe ofrojnë studentëve të programit MSHFK praktika profesionale dhe mundwsi punwsimi. Sektori i Karrierës dhe Alumnit i cili operon nën Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, ofron ndihmë dhe është në dispozicion të studentëve përgjatë praktikës profesionale dhe punësimit pas diplomimit të tyre. GVJ konfirmoi këtë proces dhe nga takimi me studentët e programit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf, Neni 15</i></p> <p><i>Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmjet UAMD dhe Partnerëve.pdf</i></p> <p><i>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet Fakultetit të Biznesit dhe Partnerëve.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e</p>	<p>Bazuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka një rregullore të Praktikës së studenteve (neni 4) për programin MSHFK, dhe me vendim Dekanati vendosen lektorët udhëheqës së praktikave dhe tezave të diplomës. Gjithashtu ngrihet një komision për mbrojtjen e praktikave ku vendosen dhe notat përkatëse.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet ndërmjet UAMD dhe Partnerëve.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Praktikës për Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>



vlerësimin të tyre për praktikën profesionale.	<i>Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet në përmbushje të plotë të këtij standarti bazuar në saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar dhe në RVB. Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit ka të angazhuar personel akademik dhe ndihmës për realizimin e programit. Departamenti ka në dispozicion një laborator, asistentë dhe softwarë të nevojshme për orët laboratorike. GVJ rekomandon që përballimi i ngarkesës mësimore të PS Master i Shkencave "Financë Kontabilitet" të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar dhe të rritet niveli i kualifikimit të stafit të angazhuar në staf me titullin Dr.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve	
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UAMD zhvillon procesin mësimorë në tre godina dhe Fakulteti i Biznesit zhvillon këtë proces në Godinen e dytë në Spitallë. Bazuar në dokumentacionin e ofruar, RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi që mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimorë për programin MSHFK janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Përkatësisht, në dispozicion janë:	
	Mjedisi - FB	Nr. Sallash
	Salla leksioni	15
	Salla & Laboratorë informatike, për aktivitete, etj	2
	Zyra për stafin	29
	Bibliotekë	1

	<p>Ambiente ndihmëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Librari/fotokopje ▪ Zyrë informacioni ▪ Mjedise sherbimi 	4
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative, të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Referenca: <i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i> <i>Infrastruktura.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>	
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës që sallat e leksionit dhe laboratorët janë të pajisura me videoprojektorë (të lëvizshëm), tabela bashkëkohore, kompjutera dhe vende pune me internet.</p> <p>Laboratorët në dispozicion të MSHFK ofrojnë rreth 80 vende për studentët dhe disa softëare në dispozicion të lëndëve të ndryshme. Në godinën e përdorur nga Fakulteti i Biznesit ofrohet dhe salla e bibliotekës për studentët dhe të gjitha ambjentet dhe zyrat e stafit janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për procesin mësimorë.</p> <p>Referenca: <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>	



të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Bazuar në DVV, RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatori që Fakulteti i Biznesit, i cili ofron programin Bachelor në Financë Kontabilitet ofron për studentët dy laboratorë, ku i dyti është shtuar rishtazi si laborator i Doktoraturës. Laboratorët ofrojnë pajisjet e duhura teknologjike dhe programet standarte dhe specifike si Financa 5, SPSS, Evieës të cilat janë në dispozicion të studentëve dhe të përshtatshme sipas natyrës dhe nevojave të programit të studimit. <i>Infrastruktura.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	N/A
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur plotësisht pasi bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion është konstatuar që UAMD ka në dispozicion të Fakultetit të Biznesit Godinën 2 e cila mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe administrative,</i>

	<i>të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të procesit mësimorë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe në vizitën në institucion konstatoi që pedagogët e lëndëve paraqesin cdo fillim semestri te studentët literaturën bazë dhe ndihmëse që do nevojitet gjatë semestrit e cila mundesohet nga vetë ato dhe biblioteka.</p> <p>Tekstet bazë janë në gjuhën shqipe, të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj. Krahas literaturës në gjuhën shqipe, në syllabus studentëve u sugjerohet edhe literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj (në gjuhën angleze) në funksion të thellimit të njohurive të fushës.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Propozim blerje librash.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>GVJ konfirmoi në takim me stafin procesin e përditësimit të literaturës e cila iniciohet nga kërkesat e tyre në njësinë bazë, e cila ndjek procesin më pas, <i>por rekomandon në përditësim të literaturës bazë referuar Syllabuseve për një pjesë të lëndëve.</i></p> <p>Referenca:</p> <p><i>Të dhëna për bibliotekën.</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që UAMD vë në dispozicion të studentëve dhe stafit të Fakultetit të Biznesit bibliotekën nr 2 (220 m²) e cila mundëson ambiente studimi dhe sociale të shfrytëzueshme për aktivitetet kërkimore dhe veprimtari promovuese.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka disponon dhe një fond të mbyllur me literaturë të përditësuar si në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, fondi fizik i saj është i përbërë nga 600 tituj libra akademikë, dhe gjithashtu është e pajisur me revista, gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivë akademike fizike dhe digjitale, të gjitha në dispozicion për mbulimin e procesit mësimorë.</p> <p>Studentët e UAMD kane akses dhe në dy biblioteka online si JSTOR dhe EBSCO. Biblioteka mund të shfrytëzohet njëjloj nga të gjithë studentët dhe personeli i universitetit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Abonim në librarinë digjitale JSTOR në kuadër të marrëveshjes ndërmjet UAMD-së dhe AADF.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe studentët e programit MSHFK, se UAMD ofron për të gjithë dhe pa pagesë paketën U- LIBRARY dhe bibliotekën online JSTOR. Studentët konfirmuan dhe përdorimin e këtyre bibliotekave në periudha të përgatitjes së projekteve apo detyrave të ndryshme të kursit.</p> <p>Biblioteka ofron dhe sistemet KOHA dhe COBISS, të cilat ndihmojnë përdoruesit për shkarkimin e librave apo artikujve shkencorë. Biblioteka është e pajisur me teknologjinë e nevojshme për të lehtësuar veprimtaritë kërkuese dhe studimore.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka nw UAMD ofron dhe sistemet KOHA dhe COBISS, të cilat ndihmojnë përdoruesit për shkarkimin e librave apo artikujve shkencorë. Biblioteka është e pajisur me teknologjinë e nevojshme për të lehtësuar veprimtaritë kërkuese dhe studimore.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstatori që Biblioteka e Fakultetit të Biznesit operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve cdo ditë të javës, duke përfshirë dhe fundjavën, në mënyrë që shërbimi për studentët të jete jo vetëm në oraret e tyre sipas programeve të studimeve por edhe e pandërprerë.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe</p>	<p>Bazuar në RVB, dokumentacionin e ofruar, dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi që Departamenti i Financë Kontabilitetit, përgjegjëse për programin e MSHFK, në periudhë të vazhdueshme evidenton nevojat e fondit fizik dhe online të bibliotekës dhe ndjek procesin e përditësimit të këtij fondi.</p> <p><i>GVJ konstatoi gjithashtu që fondi kryesor për këtë proces është i nevojshëm të jetë më i lartë, kjo për arsye të nevojës për përditësim të literaturës bazë të lëndëve që zhvillohen në programin MSHFK.</i></p> <p>Referenca:</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>

për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard është i përmbushur kryesisht, kjo e konstatuar nga DVV dhe vizita me stafin dhe studentët e programit MSHFK. Literatura bazë dhe ndihmëse e programit përmbushin objektivat e tij të studimit dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program, por kanë nevojë për përditësim të saj. Departamenti i Financë Kontabilitetit ndjek procesin e përditësimit të fondit fizik dhe online të bibliotekës, ndërkohë konstatohet nevoja për zgjerimin e këtij fondi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita në institucion që Sekretaria e Fakultetit të Biznesit dhe sekretaritë e programeve realizojnë sistemin e menaxhimit të informacionit që lidhet me studentët. Gjatë takimit në sekretarinë e programit u bë e mundur shqyrtimi i regjistrave të studentëve dhe dy dosje të zgjedhura të studentëve në programin MSHFK, të cilat rezultuan me informacion të plotë të nevojshëm sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Sistemi tjetër i menaxhimit të informacionit në përdorim është platforma PITAGORA si një sistem i informatizuar për të administruar të dhënat për të gjithë studentët që nga hyrja në universitet e deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i></p>

	<p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE, PITAGORA (RASH).pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ konstatoi se informacioni mbi stafin akademik dhe ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në programin MSHFK menaxhohet dhe arkivohet nga struktura e Burimeve Bjerëzore. Departamenti i Financë Kontabilitetit mbledh dhe perditëson informacionin akademik dhe shkencorë të stafit me anë të raporteve të vetvlerësimit dhe ja përcjell zyrës së Burimeve Njerëzore. Gjate vizitës u shqyrtuan dy dosje fizike të stafit, të cilat rezultuan me informacion të perditësuar.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e brendshme e Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike.doc</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se platforma PITAGORA, garanton akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit dhe me funksionalitetet e nevojshme të komunikimit për aspektet mësimore të ciklit akademik të studimeve pranë UAMD: si programet mësimore sipas cikleve të studimit, grafiku i provimeve, rezultatet deri në diplomim etj.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Orari Mësimor Semestral V.A 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE, PITAGORA (RASH).pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Platforma PITAGORA është sistemi që mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna për stafin dhe studentët e UAMD, por GVJ konstatoi si nga RVB dhe nga vizita në institucion që stafi përdor dhe platformat Google Classroom dhe Microsoft Teams si metoda interaktive për komunikim të vazhdueshëm me studentët dhe shpërndarjen e materialeve ndihmese dhe programit të lëndës.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE, PITAGORA (RASH).pdf</i></p>

	<i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	<p>Monitorimi në kohë reale të aktiviteti akademik nuk referohet vetem në platformat e sipër përmëndura por dhe në regjistrin e liste- prezencës, ku cdo staf akademik duhet të marrë dhe frimosë për orët mësimorë të kryera, referuar rregullores sw Fakultetit. GVJ gjykon se në tërësi sistemi i menaxhimit të UAMD garanton monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit si dhe mundëson evidentimin në kohë të problematikave dhe marrjen e masave për përmirësim nga strukturat përkatëse.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE, PITAGORA (RASH).pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p>GVJ konstatoi se në faqen zyrtare web të UAMD publikohet në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane i gjithë informacioni i nevojshëm mbi programet e studimit të ofruara, personelin akademik, aktivitetet e realizuara, si dhe shërbimet e njoftime të tjera për të gjithë të interesuarit. Gjithashtu rrjetet sociale të Departamentit paraqesin informacion të vazhdueshëm për të interesuarit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p>www.uamd.edu.al</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht, UAMD përdor disa platforma për administrimin e informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë universitetit. Sistemi aktual i menaxhimit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të UAMD. Informacioni që lidhet me të gjitha programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet & projektet etj të UAMD publikohet në faqen zyrtare të institucionit në internet në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane dhe në rrjetet sociale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në DVV dhe RVB, gjithashtu në vizitën pranë institucionit GVJ konstaton Departmaneti i Financë Kontabilitetit ka një pjesë të vecantë në strukturën e buxhetit për UAMD, e cila përfshin zërat e kostove financiare dhe është në përputhje me strukturuën buxhetore të Buxhetit të Shtetit të përcaktuar me udhëzim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomizë. Ky plan financiar i cili përllëgarit kostot e mbulimit të ciklit të plotë të studimit por edhe tarifat dhe pagesat studentore, hartohet nga Drejtoria e Financës dhe Buxhëtit të UAMD.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Dosja për hapjen e programit MSc Financë-Kontabilitet, Datë 25.05.2018.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i DVV dhe vizitës në institucion se Departamenti i Financë Kontabilitetit si njësi bazë për programin MSHFK harton një plan financiar duke përfshirë të gjitha kostot për staf akademik efektivë dhe me kontratë, kosto për materiale, literaturë, aksesin në teknologji dhe shërbime të tjera që financojnë burimet njerëzore në aktivitete akademike, investime apo projekte. Pas Departamentit plani financiar kalon në Fakultet dhe është objekt diskutimi dhe aprovimi nga senati dhe Bordi Administrimit të Institucionit, të cilëve u dorëzohet çdo vit një raport financiar për shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Auditimi i brëndshëm kryhet në mënyrë të pavarur në UAMD në përputhje me Ligjin nr 114/2015 “Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik” dhe Manualin e Auditimit të Brëndshëm. Bordi i Administrimit miraton kartën e Auditit të UAMD ku përfshihen qllimi, misioni, objektivat, përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë dhe organizimi i Njësisë së Auditimit të Brëndshëm në UAMD. Raportime periodike dorëzohen nga auditimi i brëndshëm në njësinë bazë.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Bazuar në informacionin e DVV, UAMD paraqet çdo vit akademik analizën vjetore për të gjithë veprimtaritë e kryera, pasqyrën financiare të lidhur me gjendjen, angazhimin e personelit, tarifatat etj. Ky raport prezantohet dhe është çështje diskutimi mes anëtarëve të ftuar nga Rektorati, Administratori, Bordi Administrimit, Senati, personel akademik dhe</p>

	<p>administrative dhe përfaqësues të studenteve. Raporti publikohet gjithashtu në faqen e internetit të UAMD.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> https://uamd.edu.al/vendime/</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UAMD është institucion buxhetor dhe funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kuadrit rregullator në fuqi, burimet e financimit të UAMD janë: buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera ligjore financimi; si dhe të ardhurat nga veprimtari kërkimore shkencore. Fondet e buxhetit të shtetit në përputhje me udhëzimet e MFE shpërndahen në formë granti për politikat e zhvillimit të UAMD, për mësimdhënien dhe për punën kërkimore-shkencore e veprimtaritë krijuese. Përdorimi i fondeve publike nga UAMD bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht, pasi u konstatua se UAMD harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti dhe njësie bazë dhe bën analiza financiare në nivel njësie bazë. Institucioni i nënshtrohet kontrollit dhe auditimit të brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe raportet përcillen deri në njësinë bazë. UAMD si institucion buxhetor, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

			X	
--	--	--	---	--


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UAMD, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore. Rregulloret e UAMD dhe FB specifikojnë hapat që ndiqen për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit. GVJ konstaton që këto akte janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Procesi i regjistrimit të studentëve ndiqet nga grupet e punës, të ngritura me vendim të Rektorit dhe dijeni të Bordit të Administrimit, për qellim monitorimin e këtij procesi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Statuti i UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në Statutin dhe Rregulloret e UAMD, si dhe informacionin e faqes web zyrtare të institucionit, GVJ konstaton se barazia dhe të drejtat e kandidatëve dhe studentëve të programit të studimit garantoohen edhe nga kërkesat (nenet) specifike të statutit (<i>nenet 62 & 89</i>) dhe rregullores së UAMD (<i>neni 115</i>), dhe të rregullores së FB (<i>neni 84</i>).</p> <p>Referenca:</p>

	<p><i>Statuti i UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe RVB, dhe pas vizitës në institucion, konstatoi që UAMD harton dhe bën publike kriteret dhe kuotat e pranimit për cdo cikël studimesh, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.</p> <p>Në UAMD, Departamentet propozojnë kriteret e pranimit për çdo program studimi që mbulojnë si dhe kriteret që do përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Kriteret e propozuara nga Njësia Bazë miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatin Akademik, u vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranime. Këto kritere parashikojnë dhe përfshijnë edhe kandidatë që kanë një diplomë të shkollës së mesme ekuivalente të një vendi të huaj. Pranimet e studentëve në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të veçantë të komisioneve ad-hoc, në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore, të cilat verifikohen dhe certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, të ngritura nga njësia kryesore.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Ligji për Arsimin e Lartë 80-2015.pdf</i></p> <p><i>Udhëzim nr.52 dt 03.12.2015 Për përcaktimin e gjuhëve të huaja në ciklin e II dhe III të studimeve në IAL.pdf</i></p> <p><i>Vendosja, Miratimi dhe Shpallja e Kritereve të Pranimit për MSH Financë-Kontabilitet V.A. 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit,</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se UAMD se procedurat dhe kriteret e përdorura në përzgjedhjen e studentëve, në vlerësimin përgjatë ciklit të studimeve e më pas, deri në diplomim, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të disponueshme për të gjithë të</p>




<p>njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>interesuariat. Këto kritere dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen zyrtare të univesitetit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Guida e Studentit, V. A. 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin dhe studentët konstatoi që si përpara fillimit të vitit akademik por edhe gjatë tij, UAMD organizon takime dhe aktivitete me nxënësit e interesuar duke i informuar mbi kërkesat e përgjithshme por edhe të veçanta për cdo program studimi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD ka të hartuara dhe pjesë të rregulloreve të veçanta kritere dhe kuota për kandidatë me aftësi të veçanta, kandidatë nga trojet dhe shtresave të marginalizuara. Bazuar në rregullore nën varësi të Dekanatit të Studentëve pranë Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës do të ngrihet Njësia e Shërbimit të Aftësisë së Kufizuar, e cila asiston çdo student me nevoja specifike. Gjithashtu, në kuadrin rregullator të UAMD parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të studentëve të huaj, por që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimit në programin e studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS, pa vendosur kritere të tjera specifike.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Vendimi i Senatit Akademik Nr. 36, datw 20.04.2021, Miratimi i Kuotave të Pranimit të Studentëve V.A. 2021-2022..pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Studentët me Aftësi të kufizuar.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>	<p>GVJ konstatoi se në kuadrin rregullator të UAMD parashikohet mundësia e regjistrimit pranë programeve të studimit edhe të</p>



<p>akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>studentëve të huaj, por që plotësojnë kriteret e parashikuara të pranimit në programin e studimit dhe në respektim të Udhëzimeve të MAS, pa vendosur kriteret të tjera specifike.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Vendimi i Senatit Akademik Nr. 36, datw 20.04.2021, Miratimi i Kuotave të Pranimit të Studentëve V.A. 2021-2022..pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UAMD duke ndjekur dhe kuadrin rregullator në fuqi, njofton dhe ofron bursa apo përfitim financiar për studentët e shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Programi i Transparencës, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Shpallja e Njoftimit "Kriteret dhe Procedurat e Aplikimit për Bursë Studenti, V.A. 2021-2022".pdf</i></p> <p><i>VKM Nr. 903 datë 21.12.2016 (ndryshuar VKM Nr. 39 datë 23.01.2019) Kriteret Për Bursë.pdf</i></p> <p><i>Statuti i UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se standarti përbushet plotësisht, duke konstatuar se në kuadrin rregullator të UAMD parashikohen kriteret dhe procedurat e përgjithshme të pranimit të studentëve në programet bachelor, si dhe procedurat lidhur me ecurinë deri në diplomim, përfshirë vlerësimin e dijeve dhe mundësinë e transferimit në/nga programe të tjera. UAMD respekton kuadrin rregullator në fuqi lidhur me politikën e ndihmës/bursave për shtresat në nevojë dhe për studentët cilësorë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standartit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues, informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të UAMD, GVJ vlerëson se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Rregulloret e Fakultetit dhe programit ofrojnë informacion mbi të gjithë procesin por UAMD aplikon gjithashtu dhe sistemin e automatizuar të Pitagorës, i cili jep akses studentëve të informohen në kohë reale për vlerësimet e tyre, programet e lëndëve dhe gjithë ciklit të studimeve.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE, PITAGORA (RASH).pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD përmes sekretarive të programeve të ciklit të parë dhe bazuar në rregullore të FB informon dhe orienton studentët në lidhje mundësinë për njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë për transferimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, në një program studimi të Fakultetit, merret nga komisioni ad-hoc përkatës, i ngritur nga njësia bazë pranuese.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p>

	<p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Programi i Transparencës, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vendosja, Miratimi dhe Shpallja e Kriereve të Pranimit për MSH Financë-Kontabilitet V.A. 2023-2024.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga DVV dhe vizita në intitucion, se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara në platformen Pitagora dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimin, si dhe nga sekretaria mësimore e departamentit. Studentët informuan GVJ se në cdo javë të parë te semestrit informohen dhe diskutojnë me pedagogët e lëndëve mbi procedurën e vlerësimit të tyre për cdo lëndë duke u njohur me syllabusin e lëndës.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Syllabuset e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet V.A. 2021-2022, Sem. 3.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët e programit të studimit MSHFK, GVJ konstatoi se studentët ishin të informuar lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të këtij programi studimi. Në përfundim të studimeve studenti duhet të përgatisë dhe të mbrojë tezën e diplomës, udhëhequr nga një staf akademik, për këtë ato janë të mirëinformuar nga disa burime si të publikuara në faqen zyrtare të UAMD, rregulloret përkatëse dhe nga aktivitete të organizuara nga njësi bazë.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Mikrotezës Master Profesional dhe Master i Shkencave, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p>

	<p><i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete, Dep. F-K, Drejt një rruge që sa ka nisur, praktika dhe kërkimi, roli tyre në rritjen profesionale.PDF</i></p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare të UAMD, GVJ konstatoi se çdo fillim viti akademik, Departament i Financë-Kontabilitetit në bashkëpunim me strukturat e tjera brenda institucionit zhvillon aktivitete informuese mbi programet e studimit. Gjatë takimit me stafin GVJ konfirmoi se anëtarë të departamentit përzgjidhen cdo vit për të informuar në lidhje me cdo program studimi për publikun e gjerë dhe studentët e interesuar.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UAMD vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre përmes platformës së Pitagorës, si dhe mbi procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Gjithashtu studentët kanë informacion të plotë mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në këtë program studimi dhe procesin e diplomimit. UAMD, duke angazhuar staf të departamentit, organizon aktivitete informuese për studentët e interesuar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit MSHFK informohen nga pedagogët përkatës, sekretarët dhe faja zyrtare web e UAMD për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Programi i Transparencës, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>GVJ konstatoi se përveç rregulloreve përkatëse, në dispozicion të studentëve janë edhe udhëzues e materiale informuese të përgatitura mbi organizimin dhe strukturën e programit të studimit të cilat u jepen studentëve në ditët e para në auditor dhe në faqen zyrtare apo rrjetet sociale të institucionit. Përmes platformës në përdorim dhe takimeve të organizuara studentët mund të konsultojnë syllabuset dhe informacione të përditësuara mbi veprimtaritë mësimore.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Biznesit dhe zyra e Alumnit dhe Karrierës kanë dhe lidhin marrëveshje në vazhdimësi me institucione dhe biznese për të mbështetur studentet e tyre gjatë praktikave dhe mbi të gjitha për tju ofruar mundësi punësimi. Gjatë takimit me përfaqësues së zyrës së Alumnit dhe Karrierës, GVJ u njoh me disa aktivitete që organizohen në kuadër të orientimit të studentëve drejt dhe në tregun e punës, ku më i rëndësishmi është Panairi i Punës, i cili tashmë është një traditë për UAMD.</p> <p>Referenca:</p>



	<p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës, 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Regullore dhe Plani Strategjik i Sektorit të Komunikimit Alumnit dhe Karrierës.pdf</i></p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p> <p><i>Panairi i Punës dhe Karrierës, V.A. 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Plani i Veprimtarive Strategjike të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, 2021-2023.pdf</i></p> <p><i>Njoftime, Aktivitete, Dep. Financë – Kontabilitet_WB6 CSOs for youth Employment Support.pdf</i></p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete, Fakulteti i Biznesit _Panairi i Punës dhe Karrierës në Fakultetin e Biznesit 2022.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se Sekretaritetë Mësimore, Sektori i Karrierës dhe Alumnit, si dhe pedagogët e Departamentit të Financë Kontabilitetit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi, që në fazën e regjistrimit të studentëve e më pas me fillimin e vitit akademik.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p> <p><i>Guida e Studentit, V. A. 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nëpërmjet faqes web zyrtare të UAMD dhe hapësirës së dedikuar në platformën PITAGORA, studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet dhe aktivitete të tjera të UAMD. Gjithashtu studentët, sipas programit të studimit, mund të konsultojnë orarin mësimor, grafikun dhe rezultatet e provimeve si edhe materialet e postuara nga pedagogët në faqet tyre individuale të integruara në faqen zyrtare të UAMD.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p>

	<i>Komunikim për përdorimin e Sistemit ESSE, PITAGORA (RASH).pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht pasi konstatoi se në UAMD studentët e programit të studimit MSHFK informohen nga pedagogët përkatës, sekretaritë dhe faqja zyrtare web e UAMD për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi. Informimi në distancë realizohet edhe përmes faqes web zyrtare të UAMD dhe hapësirës së dedikuar në platformën PITAGORA.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Konkretisht, Drejtoria Administrimit dhe Shërbimeve Akademike në varësi të Rektorit është struktura që në bashkëpunim edhe me Departamentet përgjegjëse, administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për çdo program studimi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB.pdf</i></p> <p><i>Regullore dhe Plani Strategjik i Sektorit të Komunikimit Alumnit dhe Karrierës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.pdf</i></p>

	<p><i>Korrespondenca elektronike e Koordinatorit të Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet dhe Specialiste Sektori i Komunikim.PDF</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>																		
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve.</p> <p>Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 4 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="593 862 1385 1232"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar</th> <th>Transferime</th> <th>Të diplomuar në total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019- 2020</td> <td>59 studentë</td> <td>0 studentë</td> <td rowspan="3">128 studentë</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>65 studentë</td> <td>0 studentë</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>43 studentë</td> <td>0 studentë</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>69 studentë</td> <td>0 studentë</td> <td>në proces</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur largime (çregjistrime). Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program studimi janë të regjistruar me numër matrikullimi. Gjithashtu gjatë vizitës, GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet personale dhe të ecurisë akademike të dy studentëve të programit të studimit MSHFK dhe konstatoi plotësinë e tyre.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB.pdf</i></p> <p><i>Regullore dhe Plani Strategjik i Sektorit të Komunikimit Alumnit dhe Karrierës.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit.pdf</i></p> <p><i>Tabelat permbledhese per Aneks_RVB 06.05.2023.docx.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>	Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Të diplomuar në total	2019- 2020	59 studentë	0 studentë	128 studentë	2020-2021	65 studentë	0 studentë	2021-2022	43 studentë	0 studentë	2022-2023	69 studentë	0 studentë	në proces
Viti akademik	Të regjistruar	Transferime	Të diplomuar në total																
2019- 2020	59 studentë	0 studentë	128 studentë																
2020-2021	65 studentë	0 studentë																	
2021-2022	43 studentë	0 studentë																	
2022-2023	69 studentë	0 studentë	në proces																



	<i>Vizita në Institucion</i>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UAMD (neni 81-83, 89 Rregullore e Universitetit dhe neni 74 pika 7 Rregullore e Fakultetit të Biznesit). Sektori i Sekretarisë Mësimore kujdeset drejtpërdrejt për ruajtjen e informacionit në formatin letër (regjistrat e sekretarisë mësimore, procesverbalet e provimeve & dosjet personale të studentëve) dhe në versionin elektronik (në sistemin e brendshëm informatik PITAGORA). Të dyja mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin dhe përdorimin e të dhënave nga personat e autorizuar, si edhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Ligji Nr.9887, datë 10.3.2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të Brendshëm në UAMD, Vendim S.A. Nr. 141 datë 27.09.2018.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me</p>	<p>Sekretarisa Mësimore e UAMD është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ, në nivel njësie kryesore e cila zhvillon veprimtarinë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Biznesit analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (statistika bazuar në notën mesatare), si dhe kalueshmërinë sipas lëndëve dhe programeve të studimit. Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së njësive bazë.</p>



<p>veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Referenca: <i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i> <i>Statuti i UAMD-së.pdf</i> <i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i> <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Fakulteti i Biznesit analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve (statistika bazuar në notën mesatare), si dhe kalueshmërinë sipas lëndëve dhe programeve të studimit. Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së njësive bazë. Gjithashtu, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë Kontabilitetit bashkëpunon me Sektorin e Karrierës dhe Alumni për vlerësimin e të diplomuarve dhe performancës së sistemit universitar, si dhe lehtësimin të procesit të rekrutimit nga punëdhënësit.</p> <p>Referenca: <i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i> <i>Rregullore e Departamentit Financë- Kontabilitet.pdf</i> <i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë- Kontabilitet.pdf</i> <i>Rregullore e Sekretarisë Mësimore FB.pdf</i> <i>Rregullore e Njësive së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i> <i>Rregullore dhe Plani Strategjik i Sektorit të Komunikimit Alumnit dhe Karrierës.pdf</i> <i>Plani Strategjik i Dep. Financë – Kontabilitet, 2021-2025.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, si dhe të transferimeve në apo nga ky program studimi. Sistemi i brendshëm i informacionit i UAMD mundëson kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe ruajtja jep siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave</p>

	<i>personale. Departamenti i Financë Kontabilitetit në bashkëpunim me Sektorin e Karrierës dhe Alumni analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UAMD në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit ka mundësuar ngritjen e Këshillave Studentore në nivel Fakulteti e në nivel Universiteti, si dhe angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatën Akademik të UAMD, në Komisionet e Përhershme dhe në Bordin e Administrimit të UAMD.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Përfshirja e Studentëve në Vendimmarrje-Këshillim-Vlerësim, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe	<p>GVJ konstatoi se në statutin e UAMD dhe rregulloret përkatëse parashikohet qartë garantimi i përfshirjes së studentëve në procesin e vendimmarrjes me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur me mandat 2-vjeçar në një proces transparent.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Statuti i UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p>

<p>me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p><i>Njoftime dhe Aktivitete_Dep. Financë – Kontabilitet_Kalendari i Aktiviteteve Shkencore, Kulturore, Sociale etj.V.A. 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Përfshirja e Studentëve në Vendimarrje-Këshillim-Vlerësim, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se aktualisht UAMD përdor në fund të çdo semestri pyetësorët për studentët për të vlerësuar procesin mësimor, stafin akademik, si dhe infrastrukturën e institucionit. Në pyetësor studentët mund të komentojnë dhe japin sugjerime mbi lëndët dhe programet e studimit që ata ndjekin. Rezultatet e pyetësorëve janë objekt diskutimi në të gjitha strukturat e UAMD dhe bëhen pjesë e analizës vjetore dhe planit të masave për përmirësim që ndërmerren duke filluar që nga departamenti.</p> <p>Gjithashtu, institucioni organizon aktivitete të hapura dhe lë hapësira në rrjetet sociale ku studentët kanë mundësi të diskutojnë dhe të japin sugjerimet dhe mendimet e tyre mbi institucionin dhe programin.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Përfshirja e Studentëve në Vendimarrje-Këshillim-Vlerësim vlerësimin mbi Procesin Akademik, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Njoftime dhe Aktivitete_Dep. Financë – Kontabilitet_Kalendari i Aktiviteteve Shkencore, Kulturore, Sociale etj.V.A. 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në takimin me stafin dhe studentët e UAMD, GVJ konstatoi se në cdo fund semestri studentët kanë mundësi të reflektojnë dhe paraqesin vlerësimet e tyre mbi procesin mësimorë dhe procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve me anë të pyetësorëve të cilët mund ti plotësojnë për cdo lëndë dhe pedagog. Ndërkohë në periudhën e caktuar të sezonit të provimeve, studentët njoftohen nga pedagogët për rezultat e tyre ne platfomen në përdorim Pitagora, duke u dhënë dhe informacion mbi kohën në dispozicion për ballafaqimin me pedagogun e lëndës, ku studentët mund të diskutojnë mbi rezultatin e tyre dhe të</p>

<p>njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>reflektojnë gabimet e tyre. Gjithashtu, bazuar në Rregullore të Fakultetit të Biznesit, neni 62, studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njesisë Kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Statuti i UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Programi i Transparencës, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Provimeve, Fakulteti i Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Pyetsori i Studentit, si e drejtë e shprehjes se mendimit për kurset e studimit dhe procesin e vlerësimit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se UAMD ka mundësuar angazhimin e përfaqësuesve të studentëve në Senatin Akademik, në Bordin e Administrimit si edhe pranë Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Institucioni përdor edhe pyetësin për studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe personelit pedagogjik sipas lëndëve, programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Kuadri rregullator i UAMD, parashikon të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin në provim.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se rregullorja e Fakultetit të Biznesit parashikohen qartë procedurat dhe strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretarite Mësimore që janë në funksione administrative nën njësinë kryesore dhe Sektori i Karrierës dhe Alumnit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Guida e Studentit, V. A. 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Programi i Transparencës, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi struktura si Sekretaria Mësimore struktura në bashkëpunim me njësitë bazë të UAMD dhe ndihmuar nga platforma Pitagora në përdorim ndjekin të gjitha procedurat, aktivitetet dhe mbajnë e përditësojnë dokumentacionin që ka lidhje të drejtëpërdrejtë me procesin mësimor. Sekretaritë dhe Sektori i Karrierës garantojnë informimin, këshillimin dhe ndjekjen e ecurisë së studentëve sipas programeve të studimit në nivel Fakulteti dhe në nivel Universiteti; si edhe kontribuojnë me të dhëna statistikore e duke ndjekur në tërësi problematikat e lidhura me studentët.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione</p>	<p>Bazuar në informacionin në RVB, organigramën dhe rregulloret të UAMD, rezultoi se shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit dhe zyra e Karrierës pranë Fakultetit të Biznesit. Në takimin me përfaqësuesin e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e kësaj strukture në bashkëpunim edhe me strukturat/zyrat e tjera të UAMD fokusohet në informim të vazhdueshëm të studentëve në lidhje me bashkëpunimet me biznesin, organizojnë trainime dhe orientime në lidhje me praktikën profesionale, gjithashtu në gjurmimin e të diplomuarve pas përfundimit të studimeve (mbështetja e Alumni FB). Ky Sektor në kuadër të orientimit dhe rritjes së kontakteve të studentëve me tregun e punës,</p>



<p>të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>organizon cdo vit Panairin e Punës. Struktura e Karrierës dhe Alumnit zhvillon aktivitetin e saj bazuar në planin vjetor të punës të miratuar ku parashikohen aktivitetet e nevojshme, si dhe harton një raport vjetor mbi performancën e saj.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.pdf</i></p> <p><i>Faqet elektronike UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se sektori i Karrierës dhe Alumnit përmes një pyetsori realizon gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe harton një raport me rezultatet e punësimit të studentëve të UAMD. Këto raporte u vihen në dispozicion të gjitha strukturave të UAMD, që nga njësia bazë, si dhe bëhen pjesë e analizave vjetore të tyre. Aktivitetet e Sektorit të Karrierës dhe Alumnit si Panairi i Punës kanë hapësirën e tyre si në faqen zyrtare të UAMD dhe në rrjetet sociale, ku publikohen aktivitetet dhe udhëzues për studentët. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se numri i të diplomuarëve në Finance Kontabilitet, të cilët janë të punësuar në profesionin e tyre është më i lartë se ai i arritur nga gjurmimi i zyrave përkatëse.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Pyetsori i Studentit, si e drejtë e shprehjes së mendimit për kurset e studimit dhe procesin e vlerësimit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht pasi konstatoi se Sekretariteti Mësimorë dhe Sektori i Karrierës dhe Alumnit të UAMD janë strukturuar në dispozicion të informimit & shërbimit të studentëve. Shërbimi i këshillimit të karrierës ofrohet kryesisht nga Sektori i Karrierës dhe Alumnit. Sektori i Karrierës dhe Alumnit dhe Alumni FB përmes pyetësorit online, realizon gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe hartojnë një raport me rezultatet e punësimit të studentëve të UAMD.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion dhe takimet e organizuara GVJ konstatoi se institucioni angazhohet për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Pedagoget janë shpesh pjesë e trainimeve dhe takimeve orientuese mbi metodat inovative, dhe aktualisht stafi dhe studentët konfirmuan përdorimin e platformave Google Clasroom dhe Teams. Platforma të përdorura për mësimdhënie gjatë pandemisë, dhe të përdorura më pas për kontakt direct me studentin duke krijuar hapësirë të cdo lëndë për shpërndaje të leksioneve, materialeve apo detyrave. Sikurse është përmendur dhe më lart, një tjetër platformë e implementuar në UAMD është dhe Pitagora. Plani Strategjik 2020 - 2025 i UAMD i kushton vëmendje ndërmarrjes së hapave për një mësimdhënie interaktive me studentin në qendër, të bazuar edhe në eksperiencën e punës me projekte. Universiteti "Aleksandër Moisiu", synon të karakterizohet gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovatore.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p>

	<p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës, 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Statuti i UAMD parashikon ngritjen e Njësive të Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në nivel Fakulteti me qëllim koordinimin e veprimtarisë së sigurimit të cilësisë sipas programeve të studimit, gjithashtu GVJ konstatoi se referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë (neni 6), UAMD praktikon disa mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të aftësive të mësimdhënies të personelit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetëtori i studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, duke vlerësuar karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanëve përkatës nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë në Rektorat. - Vlerësimi i përgjegjësive të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore. <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Kuadri rregullator i UAMD u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi: cilësinë e procesit mësimor; format e ndryshme të mësimdhënies; vlerësimin dhe kontrollin e dijeve; etj përmes pyetësorëve përkatës të realizuar nga NJSBC (rregullore neni 6), në nivel institucioni. Gjithashtu, Rregullorja e UAMD, Rregullorja e FB dhe Rregullorja e Programit të Studimit parashikojnë të drejtën e ankimimit për të gjithë studentët lidhur me procesin mësimor dhe rezultatin e kontrollit të dijeve, kundrejt një kërkesë me</p>

	<p>shkrim që i drejtohet Dekanit të Fakultetit sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, pra NJSBC referuar dhe rregullores se saj, raporton mbi vlerësimet e mbledhura së pari tek personeli akademik e deri ne Rektorat. Këto raporte janë pjesë e diskutimeve brënda departamentit duke reflektuar gjithnjë drejt përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB dhe DVV, gjithashtu dhe nga vizita me stafin dhe përfaqësues të NJSBC, GVJ konstatoi se raportet e vlerësimeve të personelit duke u bërë pjesë e mbledhjeve në department, ka si qëllim dhe diskutimet konstruktive, të cilat promovojnë praktikën e mira dhe nxisin personelin akademik për përmirësim të mëtejshëm. Gjithashtu, në takimin e zhvilluar me personelin akademik të këtij programi studimi, gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi angazhimin e institucionit për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UAMD u mundëson studentëve që në fund të çdo semestri të shprehin mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe parashikon të drejtën e studentëve për ankim dhe zgjidhje. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve në fund të çdo semestri, si dhe analizat vjetore të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Institucioni. UAMD angazhohet për nxitjen dhe promovimin e pedagogëve përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe projekte të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, në planin strategjik të UAMD, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, bazuar në analizën SWOT të realizuar në ndihmë të planifikimit strategjik, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë. Referenca: <i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i> <i>Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e	Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se, parimi i cilësisë vlerësohet si udhëheqës i aktivitetit organizativ të Universitetit dhe duke ndjekur kuadrin ligjorë NJSBC është njësi e cila ngrihet me Urdhër të Rektorit dhe ka shtatë anëtarë, nga të cilët, një përfaqësues nga stafi akademik i çdo fakulteti të UAMD-së,


<p>vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>drejtuesi i Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë në Rektorat, si dhe një student.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e DVV, RVB dhe në vizitën në institucion GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UAMD realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Konkretisht, UAMD ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në vitin 2016, me një akreditim për 4 vite akademike, dhe është ri akredituar në vitin 2021. Me vendimin Nr.18 të Bordit të Akreditimit, datë 24.03.2022 UAMD ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 4 vite akademike. Vlefshmëria e këtij akreditimi përfundon më 23.03.2026. Ndërsa për programin e studimit MSHFK ky është akreditim që kryhet për herë të parë.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësi, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se në rregulloret dhe manualët e UAMD paraqitet qartë politika e institucionit lidhur me sigurimin dhe përmirësimin periodik të cilësisë së programeve të studimit. Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanëve përkatës nga DKSC në Rektorat. Gjithashtu bazuar në dokumentacionin e DVV, u kostatua se vlerësimi i përgjegjësive të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, bëhet duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore.</p> <p>Gjatë takimit me përfaqësues së NJSBC të UAMD u konstatua se pjesë e mekanizmit të kontrollit të cilësisë në mësimdhënie janë dhe praktikat e vizitave të stafit gjatë orëve të leksioneve,</p>

	<p>ku vizitat përzgjidhen në mënyrë rastësore. Vetëvlërësimi i stafit akademik është një raport tjetër i cili referohet një formulari që plotësohet nga vetë stafi për arritjet dhe punën e tyre gjatë një viti akademik në mësimdhënie dhe në kuadër të kërkimit shkencorë.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Njesisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se në UAMD procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ndërkohë, UAMD ka marrë riakreditimin institucional me kohëzgjatje 4 vite akademike dhe programi i studimit MSHFK akreditohet për herë të parë. Mekanizmat kryesorë të monitorimit periodik janë pyetësorët e studentëve për mësimdhënien në fund të çdo semestri, raportet e vetëvlërësimit të personelit akademik, si dhe analizat e ecurisë të realizuara në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Universiteti.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike	GVJ konstatoi nga DVV se instrumenti që ofron të dhëna të rëndësishme mbi një sërë treguesish të performancës është rishikimi vjetor i veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore përgatitur nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë dhe miratuar nga NJSBC i cili përfshin, por nuk kufizohet në numrin e studentëve që diplomohen, numrin e



<p>të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>publikimeve dhe kërkimeve shkencore, mënyrën sesi funksionon sistemi i sigurimit të cilësisë, si dhe çdo ankesë për funksionimin e sistemit. Ky është një instrument i dobishëm për NjBSC-në, KPGSC-në dhe Senatit Akademik për shqyrtimin e fushave problematike dhe marrjen e vendimeve rreth alokimit të burimeve dhe zhvillimeve të ardhshme.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, DVV dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezultoi Departamenti i Financë Kontabilitetit organizon mbledhje në vazhdimësi por dhe në fund të çdo semestri mësimor ku analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UAMD sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Raporti i analizës përmban informacion sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesit mësimor, stafin akademik dhe studentët, menaxhimin e brendshëm dhe veprimtaritë ndihmëse. Ndërkohë në nivel institucioni DKSC përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësore dhe sasiore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët dhe stafi. Procesi i shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave realizohet nga DKSC e cila ja paraqet rezultatet e tyre Rektorit, Administratorit, KPGSC dhe Senatit Akademik për analiza të mëtejshme. Problematikat e evidentuara për secilin prej këtyre aspekteve shoqërohen me rekomandime dhe plan masash për trajtimin e mangësive dhe përmirësim të mëtejshëm.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p>



	<p><i>Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i DVV dhe nga takimet me drejtuesin e Fakultetit dhe Departamentit Financë Kontabilitet dhe personeli akademik, se në UAMD ka procedura formale që përdoren për mbikqyrje periodike të programeve të studimit në nivel departamenti mbi baza vjetore dhe semestrale si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përditësimi dhe miratimi i syllabuseve të lëndëve çdo fillim viti akademik; - në fund të çdo semestri, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies; - dosja e vetëvlerësimit bazuar në kërkim shkencorë dhe angazhime akademike - monitorime të procesit mësimor & analiza në mbledhjet e departamentit; <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Programit Master i Shkencave Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik,</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i DVV dhe RVB se në rregulloret e institucionit apo rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë janë të përfshira metoda të tërthorta të vlerësimit të procesit mësimorë dhe shërbejnë në përmirësimin e tij. GVJ vlerëson angazhimin e UAMD në realizimin e anketimeve online me studentët e diplomuar, e intervistave gjatë aktiviteteve si panairi i karrierës, si dhe hartimin e raporteve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e</p>

<p>ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>punësimi të studentëve dhe cilësinë e programeve të studimit që ofron.</p> <p><i>GVJ rekomandon realizimin e intervistave dhe pyetësorëve më të detajuar të të diplomuarve, duke përmirësuar numrin e përgjigjëve, gjithashtu dhe dokumentimin formal të komunikimit me bashkëpunëtorët e jashtëm. Rezultatet e tyre do sillnin rekomandime formale dhe të vjera për përditësimin e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Njesisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoit se kuadri rregullator i UAMD parashikon procedura dhe mekanizma formalë për monitormin dhe rishikimin e programeve të studimit në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në nivel institucioni DKSC përgatit raporte vjetore me të dhëna cilësorë dhe sasiore të mbledhura nga pyetësorët e shpërndarë tek studentët dhe stafi, dhe evidentohen problematikat e ndeshura apo eksperiencat më të mira si dhe nxirren konkluzione apo jepen rekomandime për përmirësimin e situatës. UAMD përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit nw DVV dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i institucionit parashikon dhe garanton përfshirjen e të gjithë aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në rregulloren e Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë përcaktohet organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e sektorëve përbërës si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm. Gjithashtu, paraqitet korniza e sigurimit të cilësisë në UAMD, roli i strukturave akademike dhe administrative në procesin e vlerësimit të brendshëm si dhe inkurajohen studentët që të jenë pjesëmarrës aktivë në procesin mësimor duke dhënë mendime përmes procedurave të vlerësimit (pyetësorëve) dhe angazhimit në strukturat qeverisëse të UAMD.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e UAMD-së.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik,</p>	<p>Bazuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit në DVV dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në UAMD, GVJ konstatoi pranë FB është ngritur Njësia e Sigurimi të Cilësisë me anëtarë nga personeli akademik dhe një student është pjesë e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi studimi.</p> <p>Referenca:</p>



<p>ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i> <i>Rregullore e Njesisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se UAMD garanton përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit duke respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit apo studentëve.</p> <p>Referenca: <i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i> <i>Rregullore e Njesisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i> <i>Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>UAMD angazhohet në përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Aktivitete si Panairi i Karrierës, leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private janë kthyer në një traditë në jetën universitare të UAMD dhe strukturat përkatëse i shfrytëzojnë edhe për ndarjen e mendimeve lidhur me cilësinë dhe përmirësimin e vijueshëm të programeve të studimit.</p> <p>Referenca: <i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i> <i>Rregullore e Njesisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht pasi konstatoi se kuadri rregullator i UAMD përcakton qartë strukturat që përfshihen në procesin e sigurimit dhe përmirësimit të vijueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit. Përmes aktiviteteve si Panairi i Karrierës,</i></p>



	<i>leksione të hapura me personalitete të fushës, marrëveshjet e ndryshme të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, UAMD realizon përfshirjen e bashkëpunëtorëve apo ekspertëve të jashtëm në procesin e vlerësimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Bazuar në informacionin e dhënë në RVD, DVV dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se kuadri rregullator i UAMD parashikon publikimin e politikave, strategjive dhe veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë. UAMD përdor faqen zyrtare të web- it dhe rrjetet sociale, komunikimin me email dhe takimet informuese në kuadër të këtij qëllimi.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Njësisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p>https://uamd.edu.al/transparenca/</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Publikimet në faqen zyrtare web të UAMD dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Informacioni në nivel programi studimi dhe departamenti përcillet tek struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes publikimeve në faqen zyrtare ëeb të UAMD dhe komunikimeve në platformën Pitagora.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p>

	<p><i>Rregullore e Njesisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p>https://uamd.edu.al/transparenca/</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se pas vlerësimit të personelit akademik, raportet përcillen nga NJSBC në njësinë bazë të programit dhe FB. Raportet pasi u bëhen me dije personelit, diskutohen duke ndarë praktikën e mira dhe duke marrë masa për përmirësim të vazhdueshëm mbi problematikat e evidentuara.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Rregullore e Njesisë së Sigurisë së Brendshme të Cilësisë, UAMD.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, GVJ konstatoi se në UAMD realizohen periodikisht analiza në nivel fakulteti dhe departamenti mbi ecurinë e politikave dhe strategjive, duke reflektuar dhe ndryshimet e nevojshme dhe përmirësimet e nevojshme. Referuar Planit Strategjik të UAMD, vlerësohet efektiviteti dhe impakti i veprimtarive në kuadër të vlerësimit të cilësisë dhe përmirësimin në vijim.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB, Master Finance kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Analiza Vjetore 2018-2022, Departamenti Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Analiza e tregut të punës në hapje të programit MSH në Financë-Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Plani i Zhvillimit Strategjik të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës, 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmoi aktivitetet e organizuar në nivel fakulteti dhe departamenti në kuadër të përditësimit me ndryshimet dhe përmirësimet e mëtejshme. Aktivitetet si Panairi i Punës, Forumet e Hapura, nisma mbi transparencën të publikuara dhe në faqen zyrtare të UAMD kanë objektiv kryesorë ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive në sigurimin dhe</p>

cilësisë së programit të studimit.	<p>përmirësimin e cilësisë të personelit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm të fushës.</p> <p>Referenca:</p> <p><i>RVB Finance Kontabilitet.pdf</i></p> <p><i>Leksionet e hapura dhe aktivitetet Dep. Financë Kontabilitetit.pdf</i></p> <p><i>https://uamd.edu.al/transparenca/</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ shprehet se standarti përmbushet plotësisht pasi konstatoi se UAMD publikon informacion të dedikuar mbi sigurimin e cilësisë me qëllim informimin e studentëve dhe të gjithë palëve të interesuara. Materialet e publikuara dhe raportet e analizave të zhvilluara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Institucioni angazhohet për ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të personelit dhe studentëve, në sigurimin dhe përmirësimin e vijueshëm të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Financë-Kontabilitet”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni gëzon emër të mirë dhe ka përvoja të mëparshme të sukseshme në programe studimi cilësore në fushën ekonomike, të cilat ofrojnë një suport të mirë për ofrimin e programit aktual të studimit;
2. Programi i studimit ofrohet në një fushë e cila perceptohet si një nevojë përherë e madhe për t'u plotësuar dhe mbyshur me specialistë përkatës;



3. Një larmi e konsiderueshme e marrëveshjeve të bashkëpunimi me partnerë vendas dhe sidomos të huaj;
4. Angazhim në gjithnjë e më shumë projekte kërkimore të financuara brenda dhe jashtë vendit;

b. Pika të dobta:

1. Lëndët e ofruara në Planin Mësimor të Programit të Studimit janë organizuar në një mënyrë që nuk garantojnë plotësisht ofrimin e njohurive të balancuara për studentët. Lëndët kanë dublim me disa lëndë të ofruara edhe në nivelin e parë të studimeve Bachelor me të njëjtin emërtim në të njëjtin Institucion, duket se anojnë nga lëndët e profilit kontabilitet e më pak financë si edhe përfshijnë lëndë jo prioritare për programin e studimit; *(Standardi II,1 konkluzione)*
2. Tërësia e lëndëve nuk përfshin lëndë të Etikës në profesion që është një kërkesë kyce e profesionistëve të fushës financë kontabilitet, edhe në drejtim të marrjes së certifikimit përkatës profesional në vendin tonë por edhe jashtë tij; *(Standardi II.4, kriteri 6)*
3. Stafit PAE nuk mbulon të paktën 75% të ngarkesës mësimore në auditor dhe ka pedagogë me gradën Msc të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi; *(Standardi IV.1, kriteri 2)*

Rekomandime:

1. Tërësia e lëndëve të ofruara për studentët duhet të rishikohet me qëllim përfshirjen e më tepër lëndëve të profilit financë, duke shmangur njëkohësisht përsëritjet me lëndët e ofruara tashmë në nivelin e parë Bachelor dhe synuar zëvendësimin e lëndëve jo prioritare për programin e studimit me më shumë lëndë të fushës së financës. Ky rekomandim vjen duke pasur parasysh kufizimet ligjore në fuqi;
2. Përfshirja e lëndës Etikë në profesion për të mundësuar një nivel më të lartë të integritetit profesional dhe për të lehtësuar përputhshmërinë e kurrikulës me kërkesat ndërkombëtare dhe kombëtare të certifikimeve profesionale në këtë drejtim;
3. Shtimi i ngarkesës mësimore në auditor i stafit PAE dhe ulja e ngarkesës për stafin PAK si edhe kualifikimi i pedagogëve që japin mësim në mënyrë që të kenë të paktën gradën Doktor i Shkencave;

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science in Finance and Accounting

a. Strengths and Affirmations:

1. The institution, with a strong reputation and a history of successful experiences in quality study programs within the economic field, offers valuable support to the current study program;
2. The field of study program being offered is recognized as a significant need that requires the expertise of relevant specialists;
3. The institution has established a significant number of collaboration agreements, with domestic and particularly with international partners;
4. Active involvement in an increasing number of funded research projects, both domestically and internationally;

b. Weaknesses:

1. The subjects within the curriculum of the study program are structured in a manner that does not ensure the delivery of a balanced knowledge for the students. Notably, there is duplication of subjects, with some subjects being repeated even at the first cycle level of Bachelor studies, within the same institution. There appears a trend in favor of the accounting profile over finance and incorporate of non-priority subjects for the study program; *(Standard II,1, conclusions)*
2. The entirety of subjects in the curriculum lacks components related to Ethics in the profession, a crucial necessity for professionals in the fields of finance and accounting, also in terms of obtaining the relevant professional certification in our country but also abroad; *(Standardi II.4, criterion 6)*.
3. The PAE staff does not fulfill the requirement of covering a minimum of 75% of the teaching load in the auditorium. Furthermore, lecturers holding MSc degrees are involved in teaching within this study program; *(Standardi IV.1, criterion 6)*

Recommendations

1. The entire array of courses provided to students warrants a thorough review to incorporate a greater number of finance-focused courses. This should be done with a concurrent effort to eliminate overlaps with courses already presented at the bachelor's level. Additionally, there is a need to substitute non-priority courses within the study program with more courses pertinent to the field of finance. It is crucial to undertake this revision while following the prevailing legal restrictions;
2. The addition of the Ethics subject in the profession aims to enhance professional integrity and align the curriculum with both international and national prerequisites for professional certifications in this domain;
3. Increasing the teaching load for the PAE staff in the auditorium is recommended, accompanied by a reduction in the workload for the PAK staff. Additionally, it is advisable to ensure that lecturers engaged in teaching hold a minimum qualification of a PhD degree;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

